



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRADANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. <u>01</u>	Nr./Br./No. <u>27317</u>
Nr. i lag no. pg <u>01</u>	Data Datum <u>11/09/</u> Dati <u>2026</u>

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 11.09.2026

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesja e Kuvendit, më datë: 23.07.2026,

T H Ë R R E T

Mbledhjen e VIII të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Hënë**, më datë: **21.09.2026**, duke filluar në orën **10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhjen propozoj këtë:

R E N D I T E


1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë: 30.07.2026;
2. Pyetje legjislativi drejtuar ekzekutivit;
3. Propozim-vendim për miratimin e Buxhetit Komunal për vitin 2027 dhe parashikimet për vitet 2028-2029;
4. Propozim vendim për dhënien e pëlqimit paraprak për shfrytëzimin afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës – njësitë kadastrale P-71107041-01338-0, P-71107041-01339-0 dhe P-71107041-1336-1, në Zonën Kadastrale Kamenicë;
5. Propozim-vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të komunës – njësitë kadastrare P-71107041-01338-0, P-71107041-01339-0 dhe P-71107041-1336-1, në Zonën Kadastrale Kamenicë;
6. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimeve Sh.01.Nr.12089, Sh.01.Nr.17991, Sh.01.Nr.17985 dhe Sh.01 Nr.1798, Sh.01.Nr.17974, Sh.01 Nr.22376;
7. Propozim vendim për subvencionimin e transportit lidhës për fshatin Kopërnice;
8. Të ndryshme.

Arbore BEQIRAJ FERA

Kryesuese e Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e VII-të, e rregullt e Kuvendit të Komunës së Kamenicës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës më datë: 31.07.2026 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç disa delegatëve të kuvendit, të pranishëm tjerë ishin: Kryetari, Nënkryetarja e Komunës, Shërbimi profesional i kuvendit, drejtor të drejtorive komunale, përkthyesi, zyra e informimit, zyrtar komunal, përfaqësues të OSBE-së. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Kuvendit të Komunës, znj. Arbnore Beqiraj Fera, e cila për mbledhje propozoi këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë: 30.06.2026.
2. Pyetje legjislativi drejtuar ekzekutivit.
3. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës së Kamenicës për gjashtëmuajorin e parë (Janar-Qershor) të vitit 2026;
4. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetori i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Prill – 30 Qershor (TM2);
5. Propozim vendim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Asfaltimi i rrugës ‘Shyt Vaku’ – Degëzim”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit me Znj.Shqiponjë Pira;
6. Propozim vendim për caktimin e kompensimit për anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM “Higjena” dhe në NPL “Dardana” SH.A në Kamenicë;
7. Propozim vendim për pëlqim paraprak dhe inicim të procedurës së shprehjes së interesit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale;
8. Propozim vendim për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
9. Propozim vendim për lejimin e mjeteve financiare për Kryqin e Kuq të Kosovës – Dega Kamenicë;
10. Propozim vendim për emërimin e Nënkryetarit të Komunës së Kamenicës për Komunitete;

11. Propozim vendim për ndryshimin dhe Plotësimin e Vendimit Sh.01.Nr.21967 i datës 12.08.2025 për formimin e Komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh.01.Nr.5541 i datës 03.03.2026;

12. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimeve Sh.01.Nr.15152, Sh.01.Nr.15160, Sh.01.Nr.15161 dhe Sh.01.Nr.15156, të datës 05.06.2026;

13. Të ndryshme.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, I nderuari Kryetar i Komunës z. Kadri Rahimaj, nënkryetare e komunës Arta Bajralija, të nderuar koleg asambleistë, të nderuar drejtor, monitorues dhe të pranishëm të tjerë mirë se keni ardhur në mbledhjen e VII-të, të rregullt të Kuvendit Komunal për këtë vit kalendarik. Po besoj që Thirrjen dhe Materialin e keni pranuar me kohë dhe kemi korum të mjaftueshëm për hapjen e mbledhjes.

A keni propozime shtesë për rend dite ? Fjala për Kryetarin

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Përshëndetje dhe nga unë, faleminderit për pjesëmarrjen, si zyre e kryetarit i kam dy propozime për këtë seancë, **propozimi i parë është për Rialokim të mjeteve**, zakonisht në secilin vit bëjmë rialokim edhe ka kjo ka disa arsyeje, arsyeje që shpesh lidhen jo nga faktorë që determinojnë punën e përditshme të institucioneve por në këtë rast jemi të shtyrë më shumë nga indikator të jashtëm , Komuna e Kamenicës më shumë se 1 vit ballafaqohet me përmbarime me kontrata kolektive dhe si rezultat deri më tash ka arritur vlerën mbi 4.5 milion Euro dhe domosdoshmërisht neve na nevojitet rialokim i mjeteve buxhetore për të përfunduar projektet apo për të përmbushur detyrimet e kontratave, rialokimi i mjeteve mundëson që projektet të cilat kanë filluar që të përfundojnë sipas kontratës që janë lidhur, nëse kalon propozimi mund të japim kohë për diskutim drejtorisë me asambleistët, vlera që kërkohet të rialokohet është në shumë prej 235.808 euro, aq më shpejtë që ne e miratojmë këtë vendim këto mjete rialokohen.

Propozimi i dytë ka të bëjë me le të themi më shumë si një lëshim profesional ndërlidhet me miratimin e propozimit për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale nr. p-71107074-00261-1, e cila sipas planit zhvillimor komunal evidentohet si "zonë minerare", të shndërrohet në "tokë industriale", për arsyeje që është bërë një gabim, ne kemi marrë edhe një shkresë (email) nga KPMM-ja e cila tregon që ajo zonë nuk të bëjë me zonë minerare, dhe ne si institucion kemi interes

që kjo zonë të jetë si zonë industriale, që në të kemi mundësin e bashkimit si zonë ekonomike, faleminderit shumë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar, e hedhim në votim propozimin e parë nga Kryetari për Rialokim të mjeteve

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite ?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1, miratohet që të hyjë në rend dite

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, e hedhim në votim propozimin e dytë
Propozim Vendim për miratimin e vendimit për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale nr. P-71107074-00261-1, e cila sipas planit zhvillimor komunal evidentohet si "zonë minerare", në "tokë industriale"

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite ?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1, kalon ky propozim

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Edhe unë kam propozime për rend dite, të cilat veçse i kemi trajtuar në seancën e kaluar mirëpo MAPL ka kërkuar që të kemi disa ndryshime, në rend dite në pikën 12 kemi Shfuqizimin e këtyre vendimeve të cilat kemi propozim vendime ndryshimi është tek dhënia afatshkurtër-afatgjatë të cilat prona kanë qenë me destinim afatgjatë, ndërsa ne i kemi trajtuar me destinim afatshkurtër, kështu që kemi 4 propozime të cilat 2 prona dhe në kuadër të këtyre dy pronave janë edhe 2 propozime për komisione, andaj propozimi i parë ka të bëjë me:

Propozim vendim për dhënien e pëlqimit paraprak (Prona: P-71107041-01981-1 – Tek vendi i quajtur “Qendra Tregtare Zejtare” pranë hapësirës së Shtëpisë së Kulturës “Isa Kastrati”), propozim ky i cili është trajtuar në seancën e kaluar

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite ?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1, kalon ky propozim

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, vazhdojmë me propozimin e dytë:
Propozim vendim për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e shprehjeve të interesit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale,

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite ?

Për: 18

Kundër: 0

Abstenim: 0

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komuna, propozimi i tretë:

Propozim vendim për dhënien e pëlqimit paraprak (Pronat: P-71107041-01339-0 dhe P-71107041-01340-0; - Tek vendi i quajtur “Qendra Tregtare Zejtare” pranë objektit të Viva Fresh Store)

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite ?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1, miratohet edhe ky propozim

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komuna, propozimi i katërt:

Propozim vendim për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e shprehjeve të interesit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale,

Kush është që kjo pikë të hyjë në rend dite ?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1, miratohet edhe ky propozim

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, kam edhe një propozim vendim për shfuqizimin e vendimeve, të cilat do ti trajtojmë

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 1, miratohet edhe ky propozim

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, e hedhim në tërësi Rendin e Ditës në votim

Kush është për miratimin e Rendit të Ditës ?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 0, miratohet rendi i ditës

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më datë: 30.06.2026

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Pika e parë ka të bëjë me Shqyrtimin dhe Aprovimin i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 30.06.2026

A keni vërejtje apo diskutim rreth procesverbalit, pasi që nuk ka e hedhim në votim

Kush është për miratimin e procesverbalit?

Për: 19

Kundër: 0

Abstenim: 0, miratohet procesverbali me të gjitha votat PËR

2. Pyetje Legjislativi drejtuar ekzekutivit

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi tek pika e dytë pyetje legjislativi drejtuar ekzekutivit, a keni pyetje, fjala është për ju, a keni pyetje apo diskutime ? Fjala për:

Granit Berisha – Anëtar i Kuvendit Komunal, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. E kam një pyetje për Kryetarin e Komunës, në lidhje me Ujërat Atmosferike në fshatin Koretin, është bërë temë që disa ditë por nuk kemi përgjigjeje konkrete, unë e di që mundësit e Komunës nuk kanë qenë të mëdha që ta trajtojnë këtë problematikë që po vazhdon edhe përkundër investimit, para 3/4 dite që pati reshje atmosferike u shfaq e njëjta telash që e kemi pasur edhe më herët, është projekt i cili është nis por nuk po përfundon dhe janë krijuar disa situata që ne edhe nuk po kuptojmë, janë mare disa gypa diku, diku tjetër janë vendosur të rinjë, kanali diku është i hapur ndërsa diku i mbyllur, është mirë që brenda mundësive të na tregoni se çfarë po ndodhë dhe kur planifikohet të përfundoj, faleminderit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala është për:

Sejdi Kurteshi – Anëtar i Kuvendit Komunal, Përshëndetje për të gjithë. Dua të ja bëjë një pyetje Kryetarit, Udha e Fushave që është mbet që 4 vite, a ka shpresë që të kryhet këtë vit pasi që janë të bllokuara 400 h/tokë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, A e dëshiron dikush tjetër fjalën, nëse jo. Fjala për Kryetarin

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, puna e Kanalit Atmosferik është hartuar një projekt nga ingjinerët e punës së Kamenicës, të cilët parashohin një zgjidhje alternative, por jo zgjidhje të tërësishme sepse ajo donë trajtim shumë më të gjerë dhe mjete financiare shumë më të mëdha, kemi qenë të vetishëm, por mendojmë që dëmet e mëdha do ti mënjanojmë përmes kësaj zgjidhjeje alternative, nuk kemi dashur të investojmë më tepër ngase ne synojmë që të trajtohet projekti i rrugës në tërësi i cili parasheh trajtimin e të gjithë infrastrukturës, një kontratë është lidhur e cila parasheh vendosjen e tubacioneve-gypave nga betoni, kanali nuk do jetë në tërë gjatësinë i hapur, e para do jetë e panevojshme që të jetë i mbyllur në disa zona, e dyta nëse do kishim vendos të jetë krejt i mbyllur do e rrit koston financiare, kur punohet në zona vendbanimi ka kërkesa të ndryshme që

shpeshherë bëjmë zgjidhje ligjore, me mirëkuptim edhe nga kompania, vendosen gypa për ndonjë nevojë qytetare që nuk kam mundur të parashihen në projekt, Gypa të cilët konsiderohen të nevojshëm, shtesë ne bëjmë furnizim të rregullt nga Kompania tjetër që kujdesët për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve, mund të vendoset ndonjë gyp i cili është gjend aktualisht në kanalin ekzistues i cili është vendosur paraprakisht nga banorët i cili është teknikisht i pranueshëm, mund të vendoset me kërkesë të qytetarëve por jo me kërkesë të Komunës së Kamenicës.

Sa i përket rrugëve të arave, fatkeqësisht përgjigja është negative ne jemi duke u përball me mungesë të mjeteve financiare dhe këtë vit ne nuk mund ta trajtojmë si kërkesë, faleminderit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje të tjera, pasi që nuk ka vazhdojmë me pikën e tretë

3. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës së Kamenicës për gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) të vitit 2026

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, pika e tretë ka të bëjë me Raportin e Punës së Kryetarit të Komunës së Kamenicës për gjashtëmujorin e parë (Janar-Qershor) të vitit 2026, fjala për:

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Të nderuar qytetarë, të nderuar asambleistë, Drejtorë, dhe ju të pranishëm të tjerë, Ky gjashtëmujor ka një rëndësi të veçantë. Ai përfaqëson jo vetëm gjashtë muaj pune gjatë këtij viti, por edhe gjashtëmujorin e parë të mandatit tonë të ri qeverisës. Përpos që është një fillim i ri, është mundësi e re për të vazhduar punët e mira që janë bërë e po bëhen për Kamenicën. Edhe në mandatin e parë por edhe tani, qeverisjen tonë e ka karakterizuar puna e madhe dhe transparenca e plotë. Dhe këtë do të vazhdojmë ta bëjmë edhe më tutje. Në qeverisjen tonë, që nga fillimi kemi zgjedhur te mos premtojmë atë që nuk mund ta realizojmë. Përkundrazi, kemi zgjedhur që puna të flasë më shumë se fjalët. Kemi vazhduar projektet e nisura, kemi krijuar partneritete te reja, kemi siguruar investime të rëndësishme dhe kemi ndërmarrë iniciativa që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve tanë. Sot nuk po prezantojmë vetëm statistika apo shifra. Pas çdo investimi fshihet një familje që jeton më mirë, një nxënës që mëson në kushte më të mira, një biznes që zhvillohet, një rrugë që lidh fshatra dhe një qytetar që ndien se komuna po ecën përpara. Arsimi vazhdon të mbetet prioriteti ynë kryesor. Këtë vit kemi shpërblyer 24 maturantët me të dalluar me udhëtimin "Euro Trip", duke vlerësuar punën dhe përkushtimin e tyre. Kemi organizuar ceremoninë e diplomimit për rreth 200 maturantë, një praktikë që tashmë po bëhet identitet i Kamenicës dhe që tregon respektin ndaj suksesit të të rinjve tanë.

Bibliotekat e shkollave janë pasuruar me 6,750 libra të rinj falë një donacioni me vlerë rreth 20 mijë euro. Kjo nuk është vetëm shtim i numrit të librave, por është investim në dijen, kulturën e leximit dhe zhvillimin e brezave të rinj.

Gjithashtu kemi inauguruar këndin e leximit dhe kabinetin e logopedisë në Shipashnicë, duke krijuar kushte më të mira për zhvillimin arsimor dhe mbështetjen profesionale të nxënësve.

Për herë të parë organizuam Kupën e Anamoravës në Matematikë, duke e shndërruar Kamenicën në qendër të promovimit të dijes dhe bashkëpunimit rajonal. Një ndër projektet më me rëndësi mbetet përgatitja për mësimin tërë ditë. Punësoria profesionale që kemi organizuar është një hap konkret drejt realizimit të këtij vizioni, sepse besojmë se arsimi cilësor kërkon jo vetëm mësim por edhe përgatitje për jetën për nxënësit.

Në infrastrukturë, kemi filluar rehabilitimin e rrugës Kollolëq—Dajkoc—Muçivërc me investim prej 1.3 milion eurosh. Kanë nisur punimet në rrugën Koretin—Berivojcë dhe rehabilitimi i kanalit atmosferik në Koretin. Po vazhdojmë procedurat për realizimin e rrugës Shipashnicë—Desivojcë me investim afër 3 milionë euro. Po ndërtojmë rrugën qarkore në Lagien "Malësia", një projekt prej mbi 1.7 milionë eurosh. Një nga projektet më strategjike mbetet ndërtimi i mbi 50 kilometrave rrugë përgjatë kufirit, investim që jo vetëm lidh vendbanimet tona, por krijon perspektivë të re zhvillimore për gjithë zonën kufitare. Përveç projekteve të mëdha, kemi investuar fuqishëm edhe në rrugët lokale. Në Topanicë po asfaltohen 15 rrugë. Në qytetin e Kamenicës po punohet në 12 rrugë, në Hodonoc 15 rrugë, në Roganë 31 rrugë, në Muçivërc 20 rrugë, në Karaçevë të Epërme 16 rrugë, në Krilevë 18 rrugë. Si dhe dhjetëra rrugë të tjera në Berivojcë, Novosellë, Karaçevë të Poshtme, Shipashnicë, Kopërnice dhe vendbanime të tjera. Paralelisht po vazhdojmë punimet në shtratin e lumit Astrit, po përgatitet asfaltimi i rrugës në Leshtar dhe nuk po lihet anash as investimi në varrezat e Karaçevës së Epërme. Edhe në sektorin e shëndetësisë kemi pasur lajme të mira. Falë kontributit të bashkatdhetarit Muhamet Fazliu, QKMF-ja është pajisur me një autoambulancë të re. Ky është një shembull i shkëlqyer i bashkëpunimit mes institucioneve dhe diasporës sonë.

Ekonomia lokale vazhdon të forcohet. Ndërmarrja Publike "Dardana" ka shënuar rritje rekord të të hyrave prej rreth 247 %, duke u konsoliduar si ndërmarrje e qëndrueshme dhe fitimprurëse. Kemi ndarë 140 mijë euro për mbështetjen e bizneseve të reja dhe atyre ekzistuese. Kemi vazhduar mbështetjen për kulturën, rininë dhe sportin me mbi 100 mijë euro subvencione. 15 të rinj janë duke kryer praktikën profesionale në komunë, duke fituar përvojë konkrete për tregun e punës. Po vazhdon

procesi i rindërtimit të kadastrit, ndërsa kemi lansuar edhe skemën e kompostimit, një hap i rëndësishëm drejt menaxhimit modern të mbeturinave dhe mbrojtjes së mjedisit.

Po ndërtojmë Parkun e Aventurave, ndërsa është përgatitur edhe masterplani për Bahçen e Kamenicës, projekt që do të transformojë hapësirat publike në zona moderne rekreative. Janë përfunduar edhe tre "View Points", të cilat do të promovojnë potencialin turistik të komunës sonë. Qytetarët kërkojnë institucione që zbatojnë ligjin në mënyrë të barabartë. Gjatë këtij gjashtëmujori kemi parë aksione të rëndësishme për forcimin e rendit dhe ligjshmërisë. Janë ndërmarrë veprime kundër strukturave ilegale të sistemit paralel serb, ndërsa inspektorati komunal ka intensifikuar mbikëqyrjen e bizneseve. Njëkohësisht kemi vazhduar lirimimin e hapësirave publike. Janë identifikuar mbi 80 objekte ku është ndërhyrë për t'ia kthyer qytetin qytetarëve. Ne besojmë se hapësirat publike janë pronë e përbashkët dhe duhet t'u shërbejnë të gjithëve. Me investimin prej 800 mijë eurosh po modernizohet rrjeti i ujësjellësit për lagjen "Iliria" dhe Berivojcën.

122 familje kanë përfituar Baby Box me pajisje të nevojshme për foshnjat. Po investojmë edhe në fëmijët tanë përmes ndërtimit të këndeve të Lojërave në disa fshatra të komunës. Këto nuk janë vetëm investime infrastrukturore, janë investime në mirëqenien dhe cilësinë e jetës së familjeve tona. Gjithashtu me rendësi ka qenë edhe pjesëmarrja jonë në Konferencën Evropiane të Biomasës në Graz të Austrisë që ka krijuar mundësi të reja bashkëpunimi dhe shkëmbimi të përvojave për zhvillim të qëndrueshëm dhe projekte inovative. Por kjo është vetëm gjysma e rrugës për këtë vit. Na pret shumë punë. Na presin projekte të reja, investime të reja dhe përgjegjësi edhe më të mëdha.

Jam i bindur se me të njëjtin përkushtim, transparencë dhe bashkëpunim do të vazhdojmë ta zhvillojmë tutje komunën tonë. Ju faleminderit!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar, a keni diskutime apo pyetje rreth kësaj pike ?

4. Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetori i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Prill – 30 Qershor (TM2)

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e katërt e rendit të ditës që ka të bëjë me Shqyrtimin e Raportit Financiar Buxhetori i Komunës së Kamenicës për periudhën 1 Prill – 30 Qershor (TM2), ftojme drejtoreshën e Financave

Ardita Dërmaku – Drejtore për Buxhet dhe Financa, Përhëndetje për të gjithë, sot para jush do të paraqesim raportin për 3 mujorin e dytë për vitin 2026, të cilin raport e kemi pregaditur duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit në pajtim me nenin 45 paragrafi 45.2, 54.4. Ky raport përfshinë të gjitha të dhënat mbi të hyrat si dhe Investimet Kapitale. Ne fillimisht do prezantojm:

Performacën e të hyrave, në komunën tonë gjithësej të Hyra Vetanake gjatë periudhës Janar-Qershor 2026 janë 451,419.22 Euro, dhe në tremujorin e dytë (TM2) kanë shënuar një shumë prej 313,709.88 Euro ose 1.90% më pak krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprakë që ishin 319.792.34 euro. Rënja e të hyraveka ardhur si rezultat i problemeve të herëpashershme në sistemin e Tatimit në Pronë. Të hyrat e tjera janë arkëtuar kryesisht nga të hyrat nga Taksa për ushtirimin e veprimtarisë, shfrytëzimi i pronës publike, taksa për leje ndërtimi dhe taksave tjera administrative.

Performanca e shpenzimeve, shpenzimet buxhetore kanë arritur në shumë prej 4,314,280.25 euro përgjatë tremujorit të dytë ndërsa për gjatë vitit 2025 në të njëjtën periudhë ato ishin 4,578,609.24 euro, apo krahasuar në % 94.23 %.

Shpenzimet për paga dhe meditare, shpenzimet e pagave përgjatë tremujorit të dytë janë 2,516,578.71 euro ndërsa gjatë vitit 2025 të njëjtën periudhë ato ishin 2,264,266.62 euro, apo krahasuar në % janë 11.14 % më të ulëta respektivisht në shumë 252,312.09 euro.

Shpenzimet në mallra dhe shërbime, gjatë këtij tremujori shpenzimet aktuale janë në shumë prej 928,363.08 euro, ndërsa gjatë vitit 2025 për periudhën e njëjtë këto shpenzime ishin 653.062.51 euro dhe krahasimi 2025/2026 për këtë periudhë shprehur në % është prej 42.16 %, respektivisht në diferencë prej 275.300.57 euro. Ky ndryshim vërejtje që gjatë vitit 2026 janë paguar disa nga obligimet kontraktuale të mbetura nga viti fiskal 2025. Shpenzimet e tërësishme të Mallrave dhe Shërbimeve në raport me buxhetin e planifikuar për këtë periudhë janë 38.04%.

Shpenzimet komunale, kanë shënuar një shumë prej 101,258.71 euro dhe krahasuar me vitin 2025 në të njëjtën periudhë ka një rritje prej 72,014.88 euro krahasuar me vitin 2025 që ishin 29,243.71. Ky ndryshim është për faktin se nuk ka qenë aprovuar buxheti me kohë dhe ka pasur një akumulim të fakturave të pashlyera për shërbime komunale. Pjesëmarrja e shpenzimeve komunale në raport me

buxhetin e planifikuar është 38.65 %.

Shpenzimet për subvencione dhe transfere, Vlera e shpenzuar në këtë kategori për tremujorin e dytë për vitin 2026 është 279,079.35 euro, ndërsa për periudhën e njëjtë të vitit 2025 kanë qenë 191,571.45 dhe janë më të larta në vlerën 87,507.90 Euro, ose shprehur në % 45.68 %.

Shpenzimet Kapitale, Investimet kapitale janë njëra nga kategoritë më të rëndësishme të buxhetit komunal deri në këtë fazë Prill-Qershor janë shpenzuar 489,000.52 euro, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ishin 1.401.784.89 euro, me një diferencë prej 912.784.37 euro. Ky ndryshim është si rezultat i vendimeve gjyqësore përmbarimore në vitin paraprak. Me kaq po e përfundoj ju i keni edhe tabelat dhe për çdo sqarim apo pyetje jam në dispozicionin tuaj, faleminderit për vëmendje!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit drejtoresha Ardita, a keni pyetje apo diskutime rreth kësaj? Nuk ka

5. Propozim vendim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Asfaltimi i rrugës ‘Shyt Vaku’ – Degëzim”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit me Znj.Shqiponjë Pira

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e pestë që ka të bëjë me . Propozim vendim për buxhetimin e bashkëfinancimit dhe krijimin e kodit të ri për projektin “Asfaltimi i rrugës ‘Shyt Vaku’ – Degëzim”, në mes të Komunës së Kamenicës dhe participimit me Znj.Shqiponjë Pira, fjala për këtë pikë e kalojmë te :

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, ky është propozimi i tretë që vjen në formë të këtij bashkëpunimi, në mes të komunës dhe komunitetit apo në emra të përveçshëm, në këtë rast kemi të bëjmë me një emër të përveçshëm që ndërlidhet me botën biznesore, znj. Shqiponjë ka vendosur që të investoj kapitalin e saj nga Zvicra këtu në Kosovë, në një fabrikë të ujit ku gjithë ujin do ta transportoj për shitje në tregun zviceran dhe si produkt nuk do të jetë në tregun Kosovar, dhe kjo është shumë e mirë që një produkt Kosovar të eksportohet në tregun e jashtëm dhe si Komunë ne kemi vendosur që të bashkë financojmë në rrugën deri te fabrika që tashmë është ndërtuar, ku vlera e këtij projekti të përlllogaritur është 74 mijë euro, ku Komuna e Kamenicës do të bashkëfinancojë në vlerë prej 51 mijë euro dhe znj. Shqiponjë Pira në vlerë prej 22 mijë euro, po besoj që është një shancë i mirë që edhe ne si komunë që këto biznese vijnë nga diaspora dhe investojnë në Kosovë. Faleminderit!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime, fjala për:
Granit Berisha – Anëtar i Kuvendit Komunal, faleminderit Kryesuese, po besoj që është mirë për ne të dimë, pasi që po epën paret e komunës dhe Kryetari më herët tha që po kemi vështirësi financiare dhe në të njëjtën kohë ne po i ndaj po 54 mijë euro që ti asfaltojmë rrugën një biznesi, a mund të dijë sa është vlera e investimit dhe cili ka me qenë përfitimi i komunitetit apo më mirë të them sa do jetë numëri i të punësuarve në këtë biznes, faleminderit.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Ne jemi keq financiarisht, por jo edhe aq keq sa të themi që është një krizë financiare, kjo do ishte një krizë financiare po mos të kemi mbështetjen e nivelit qendror mirëpo fal mbështetjes komuna po ia del jetojë punën e vet në ato kontrata, vlera e investimit në këtë rrugë është 74 mijë euro, ndërsa vlera investive në biznes sipas deklaratës së zonjës është 1.6 milion euro. Të punësuar fillestar sipas deklaratës do jenë 12 persona dhe ky është përfitimi i komunitetit tonë në Kamenicë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar, fjala për:

Faton Jakupi – Anëtar në Kuvendin Komunal, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje Kryetar dhe Delegat të nderuar, unë përkrahi idenë që Komuna e Kamenicës të jetë afër bizneseve të Kamenicës, a prek rrugën që Komuna e Kamenicës ka marrëveshjen me Gyrshin, a jeni tu rregulluar rrugë që Komuna e Kamenicës veç ka marrëveshje një pjesë apo është fjala për degëzime prej rrugës së Kikës deri te Fabrika ?

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit shumë, Faton. Jo nuk preket rruga apo trasea kryesore që është në marrëveshje me Kompaninë Gyrsh.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime të tjera rreth kësaj ? Pasi që nuk ka, shkojmë me procedurë votimi

Kush është për miratim ?

Për: 17

Kundër: 1

Abstenim: 1, miratohet.

6. Propozim vendim për caktimin e kompensimit për anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM “Higjena” dhe në NPL “Dardana” SH.A në Kamenicë

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e gjashtë Propozim vendim për caktimin e kompensimit për anëtarët e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM “Higjena”

dhe në NPL "Dardana" SH.A në Kamenicë, me këtë vendim caktohet kompenzimi për këta anëtar i cili pra mirët me vendim të veçantë për mënyrën e pagesës për këta anëtar, nëse keni diçka të pyetni apo diskutoni rreth kësaj pike, nëse jo vazhdojmë me procedurë votimi

Kush është për miratim ?

Për: 18

Kundër: 1

Abstenim: 0, miratohet.

7. Propozim vendim për pëlqim paraprak dhe inicim të procedurës së shprehjes së interesit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e shtatë Propozim vendim për pëlqim paraprak dhe inicim të procedurës së shprehjes së interesit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, fjala për Kryetarin

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, ashtu siç ju ka ardhur edhe si pikë e rregullt e rendit të ditës, ne synojmë që të ndjekim komplet kornizën ligjore për pronat komunale në konsultim edhe me aktet e komunave të tjera, fillimisht për pronat që synojmë ti japim për kohë më të gjatë kërkohet një shprehje e interesit kjo nuk nënkupton në asnjë formë që domosdoshmërisht prona është dhënë por kjo i hap rrugë dhënies së pronës me shprehje të interesit, konsiderojmë që Komuna e Kamenicës disa prona që i ka duhet të shfrytëzohen në mënyrë sa më ekonomike në interes të qytetarëve dhe qytetit dhe besoj që është një mundësi që secili mund të jep kontribut në këtë drejtim dhe ne realisht mirëpresim secilën ide që ju konsideroni të nevojshme, faleminderit shumë.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje, fjala për :

Granit Berisha – Anëtar i Kuvendit Komunal, Faleminderit Kryesuese, ne biseduam dhe në mbledhjen e KPF-së dhe unë mendoj që ky Propozim vendim është në kundërtënie me vetë vetën, prona i ka 13.258 m² dhe në pikën e 2 të këtij propozimi thuhet një pjesë e kësaj prone do të epët në shfrytëzim, ndoshta administrativisht ka qenë e duhur që njëherë të ndahet fillimisht dhe ne ta dijëm se sa m² po i votojmë sot dhe cila pjesë e pronës po epët në shfrytëzim, faleminderit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje, fjala për :

Labinot Haxhiu – Anëtar i Kuvendit Komunal, unë po lidhëm më shumë në mënyrën se si e shpjegojë Kryetari, ne jemi për secilën pronë që i epët një biznesi se në këtë formë mund të

kontribuojmë me zhvillu Kamenicën por është kundërthënëse me atë se çfarë po bëni ju po mbjellni Grur dhe po doni që pronat publike ti shfrytëzoni vet ndërsa këndej thoni që është interes i joni me ja dhanë një biznesi, unë pajtohem me të dytën por kurrësi me të parën pasi që koha e kooperativave veç ka përfunduar.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Faton Jakupi, Magbule Kastrati
Faton Jakupi – Anëtar i Kuvendit Komunal, Ju e dini delegat të nderuar që Komuna e Kamenicës para pak kohe ka miratuar PZHK-në dhe nuk kam informacion të saktë se ku ka arritur Harta Zonale, derisa ne po flasim për Qendrën e Qytetit, përveç Hartës Zonale duhet ligjërisht me pas planë dhe mandej me u bazuar në këto plane dhe më dhanë sipërfaqe të nevojshme që biznesi e kërkon. Edhe ne përkrahim politikat ku Komuna bënë partner me biznese por jo në këtë formë dhe si e tillë konsideroj që është procedurë e ngutshme, nuk e di si numër në njësi bashkërisht, e kujtoj kohën kur është fituar Komuna të drejtën e pronësisë në Gjykatë, kujtoj kohën kur është mare edhe shkalla e dytë e Gjykatës për pronësinë e kësaj toke, ka qenë një numër i parcelës mandej qenkan ndarë, nuk e keni te listat e veçanta kur e keni dhënë 1 vit paraprak për dhënien e pronës publike në shfrytëzim.

Magbule Kastrati – Anëtare e Kuvendit Komunal, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Unë do votoj kundër kësaj pike sepse në KPF nuk ka kaluar kjo pikë dhe nuk është urgjente kryetar që ka hyr në rend dite sot, mund ta trajtojmë edhe në mbledhjen e ardhshme, po besoj që nuk është shumë urgjente, faleminderit!

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Edhe asambleisti Granit edhe Magbule sa i përket kësaj pike për KPF unë mendoj që kjo pikë nuk ka pasur nevojë të vijë në KPF, në KPF trajtohen pika e rendit të ditës që zakonisht kanë karakter financiar, kjo si Shprehje e Interesit për prona nuk nënkupton që domosdoshmërisht ka të bëjë me KPF, Kuvendi është organ vendimmarrëse dhe i takon fjala e fundit, asgjë nuk është për ngut këtu jemi që 5 vite, edhe sikur ta sjellim në KPF prapë nuk e voton. Çka është shumë e rëndësishme ajo që u potencua nga Asambleisti Faton që gjithçka epet në shfrytëzim do kujdesemi që të jenë në përputhje me planet komunale, edhe sikur ne të duam të japim diçka jashtë planeve komunale si PZHK dhe Plan Urban që është nga viti 2014 nuk mundemi e kemi një organ që i kthen vendimet siç është MAPL-ja, ashtu siç i trajtuam edhe ne tash si shfuqizim të vendimeve apo plotësim të vendimeve, po kujdesemi që gjithçka që është vendosur në planet zhvillimore komunale të jetë asi soji, po edhe në planet zhvillimore urbane . Sa i përket Hartës Zonale si informacion është po thuajse në Draftin e fundit e kemi përzgjedhur edhe kompaninë për vlerësimin e ndikimit në mjedise, pas procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedise ne mund ta sjellim

për aprovim në kuvend nga fundi i vitit, pasi të ezaurojnë pëlqimet në Ministritë përkatëse. Komuna e Kamenicës ka shumë prona publike dhe ato duhet të trajtohen në forma të ndryshme me interes të ndryshëm, ne mundemi me mbjell dhe grurë dhe nuk e di cila është kritika e juaj si subjekt politikë, por unë e di që tinërrësisht e keqe 230h janë dhënë në mandatin e ish qeverisjes suaj, i nderuar që as Aeroporti i Prishtinës nuk i ka, 230h në majën më të lartë në Kamenicë janë bllokuar tash e 7 vite dhe lënda ka shkuar në Gjykatë dhe krejt kjo si pasoj e atij vendimi të dëmshëm, ne kishim mundur të bëjmë një investim të ri, e tek e fundit ne po mbjellim grurë, për informacion koha e korporatave nuk ka përfunduar bile në Evropë korporatat janë duke u shtuar dhe duke u stimuluar nga vetë fermerët por jo në variantin që keni dëshirë me paraqit, kjo është çështje tjetër si ne duam të qasemi informacioneve të reja, por unë siguroj që çdo hapë që mirët për këtë pronë dhe secilën pronë kanë me qenë në koordinim edhe me kuvendin dhe në përputhshmëri të plotë me planet zhvillimore komunale dhe me planet zhvillimore urbane. Faleminderit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për:

Labinot Haxhiu – Anëtar i Kuvendit Komunal, Kryetar kur të më keqkuptosh pastaj krejt se çka thua është gabim, se unë nuk thash koha e korporatave por kooperativave, tash u riktheve në temë, e dyta asgjë nuk të garanton ty që një pronë që vlera e tokës është shumëfish më e madhe e 13 h në qendër se e atyre 230h në Kikë, asgjë nuk të garanton ty se fituesi nuk ka me mundur me implementu edhe ti ke me zvarrit në Gjykatë, ne nuk mundemi me paragjykuar a ka me investuar në këto 13 h kushdo që e merë, ashtu siç asgjë nuk i ka garantu ish kryetarit që ka me investuar, ashtu siç nuk mund të shkojmë me një plan uniform veç grurë apo të ju japim toka bizneseve, uniformë duhet të jetë logjika dhe ideologjia politike, nuk mund ti me dhezë temë hajde çka po bajm po mbjellim grurë, e në anën tjetër vjen këtu dhe lobon për me ju dhanë tokë në shfrytëzim bizneseve për të cilat unë jam për, por nuk jam për kooperativave, me tentua me i kthye kooperativave. Ju kisha lutur që kur doni me kthyer përgjigje, mos më keqkupto.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për:

Faton Jakupi – Anëtar i Kuvendit Komunal, dua të kthehem tek 230h në Kikë, ka qenë si vizion apo mundësi më e mira e mundshme për zhvillimin e Komunës së Kamenicës, aktualisht është e bllokuar por është me faj të Komunës, duhet të pranohet dhe fajësia dhe kritika, në marrëveshje mes palëve është dhe komuna, komuna harton plan detal të zonës, dhe plani detal nuk është bërë ashtu siç u bë PZHK apo Harta Zonale, të njëjtën situatë e kemi po frigohem edhe në Qendër të Qytetit ku vlerësimi i pronës është mos të them 10 fish me 200h është e barabartë, apo dy herë më e madhe dhe

ne prapë si komunë do hyjmë në penallti në situata ku nuk je gati me dokumente komunale zyrtar me mbuluar marrëveshjen, pse nuk je ose keni me u diktua në Hartën Zonale të planit urban në projektin e thirrur të palës private kena me ju akomoduar interesave të tij për zonën përreth, deri sa ne nuk e kemi një planë detal të miratuar unë vlerësojë që është procedurë e ngutur, unë jam për bashkëpunim me bizneset por aktualisht këtë nuk mund ta votoj.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, E para, Ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës publike i trajton në të njëjtën gjuhë të gjitha pronat, nuk po e kuptoj pse plan të veçantë për një zonë të caktuar kur ligji nuk e kërkon këtë gjë, nëse ne kemi dhënë 100m më larg në vijë ajrore prapë është qytet prapë është zonë e qytetit dhe atë pa plan detal, e pse tash nuk po bënë këtu, e para me ju siguruar nuk ka kërkesë biznesore, ka kërkesë institucionale me u bërë shprehja e interesit që me j thanë dikujt eja dhe investo, kur të bëjmë këtë vendim do e caktojmë ne vet se çka me investuar, kjo duhet të jetë e qartë për të gjithë ne. Në raporte me Kikën nuk është pikërisht ajo që ne jemi sfiduar që komuna ka marrë obligim me ba plan të detajuar dhe nuk mund të bësh plan të detajuar me plan zhvillimor të skaduar dhe plane të tjera të pa përfillshme, aty ka pasur mangësi të mëdha në marrëveshje gjatë hartimit me apo pa dashje, hapi i parë nuk është paguar qiraja që decidivisht thuhet në kontratë që nëse nuk paguhet qiraja do shkëputet kontrata, vetëm një gjysmë qira është paguar dhe më asnjëherë, pra parimi i parë në kontratë është që investitori duhet të paguaj qiranë që për atë kontratë është diku 1300 euro vlera ku përpjesohet me 230 h, varësisht që nganjëherë e mira që vije nga një investim është e kuptueshme dhe nuk kompensohet me një vlerë financiare, por hapi i dytë ka qenë dhe ka një anomali shumë interesante brenda marrëveshjes, datë tjetër e nënshkrimit ndërsa datë tjetër e protokollit, janë disa anomali që ne i kemi vërejtur që investitori është dashur bashkë me institucionin të tregohen më serioz dhe e treta unë besoj që kemi qenë shumë bashkëpunëtorë me investitorin potencial ku edhe në PZHK e kemi destinuar saktësisht kërkesën e tij edhe pse kemi lëshuar shkresë zyrtare që edhe plani i vjetër komunal e lejon investimin e tij po eja dhe apliko për leje komunale, do isha shumë i lumtur që ta kemi në një seancë pikë të rendit të ditës dhe të sjellim të gjitha faktet është pronë shumë e madhe dhe duhet të trajtuar si Kuvend Komunal.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit kryetar, fjala është për ju Labinot por duhet të jetë e shkurtë.

Labinot Haxhiu – Anëtar i Kuvendit Komunal, në mbledhjen e kaluar pata në pyetje Viva Fresh-in, je duke u sfiduar me një kontratë e cila ka skaduar gjatë mandatit tuaj, dhe nuk mund të jepesh epilog, njëjtë ka ndodhur edhe me tarifën e “Eco higjenës” njëjtë i ke pasurë gjitha procedurat që unë

fillimisht kamë thënë që jeni duke gabuar proceduralisht, tash ne nuk mund të themi hajde procedura në gjykatë hajde ti jepe një epilog ka mare fund ajo punë, mos e mirë temën prej këtyre 13 h, me qitë te Kika e me thanë është gabim data e protokollit ajo e nënshkrimit, unë nuk e kam parë kontratën por më duket që po e largon temën prej këtu, unë pajtohem me logjikën për të ju dhënë pronë bizneseve.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni pyetje apo diskutime të tjera, pasi që nuk ka vazhdojmë me procedurë votimi

Kush është për miratim ?

Për: 15

Kundër: 4

Abstenim: 0, miratohet.

8. Propozim vendim për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e tetë Propozim vendim për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, ky komision sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhet nga 5 (pesë) anëtar 2 (dy) përfaqësues nga ekzekutivi, 2 (dy) përfaqësues nga kuvendi dhe 1 (një) nga sektori jo qeveritar, shkojmë me propozime:

LVV propozon Berat Dërmaku

PSD propozon Djellonë Rrudhani

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, i hedhim në votim

Kush është për miratim ?

Për: 15

Kundër: 0

Abstenim: 2, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

9. Propozim vendim për lejimin e mjeteve financiare për Kryqin e Kuq të Kosovës – Dega Kamenicë

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, kalojmë te pika e nëntë Propozim vendim për lejimin e mjeteve financiare për Kryqin e Kuq të Kosovës – Dega Kamenicë, kemi kërkesë nga Kryqi i Kuq për lejimin e mjeteve në vlerë prej 1990 euro, për mbështetjen e realizimit të veprimtarive humanitare të Kryqit të Kuq – Dega në Kamenicë, si dhe për mbulimin e shpenzimeve të nevojshme operative për funksionimin e degës, përfshirë shpenzimet e energjisë elektrike, furnizimit me ujë, shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, internetit, regjistrimit dhe mirëmbajtjes të automjetit, si dhe shpenzime të tjera të domosdoshme për realizimin e veprimtarisë së saj. A keni diskutime rreth kësaj pike ? Nëse jo vazhdojmë me procedurë votimi

Kush është për miratim ?

Për: 17

Kundër: 0

Abstenim: 0, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

10. Propozim vendim për emërimin e Nënkyetarit të Komunës së Kamenicës për Komunitete

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e dhjetë propozim vendim për emërimin e Nënkyetarit të Komunës së Kamenicës për Komunitete, fjala për Kryetarin e Komunës.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, faleminderit kryesuese, është bërë traditë dhe unë mendoj që është bërë traditë e mirë institucionale emërimi i nënkryetarëve nga komuniteti pakicë, zakonisht kjo është edhe ligjërish por Komuna e Kamenicës duke parë që nuk e ka përqindjen e komunitetit që jeton në pakicë konform normës së përcaktuar ligjore, këtë vullnet ia kalon kuvendit komunal së bashku me ekzekutivin i cili inicion, ne kemi sjell emër për propozim për nënkryetar të komunitetit pakicë dhe unë do jap një CV të shkurtër që do ta lexoj, bëhet fjalë për Dalibor Filipovic, i lindur më datë 07.06.1978, jeton në Kamenicë në fshatin Ajnoc, ka shkollim Universitar, punon në Shkollën “Desanka Maksiovic” që nga viti 2026. E flet dhe kupton Gjuhën Shqipe mesatarisht, njeh punën me kompjuter, deri në vitin 2006 ka udhëheq OJQ dhe ka bashkëpunuar me organizatat UNHCR, CAR, ARC, ashtu siç e thashë nga viti 2006 punon në Shkollën “Desanka Maksimovic”, nga viti 2008 deri në vitin 2018 ka qenë Kryetar i bashkësisë lokale në fshatin Ajnoc, mirët me Politikë, ka të regjistruar një Iniciative qytetare së bashku për Kamenicën. Në vitin 2021 është emëruar nënkryetar për Komunitete në Komunën e Kamenicës dhe pas 3 muajsh ka dhënë dorëheqje për arsyeje të akuzës për nxitje urrejtje në postim në profilin e tij, por pas hetimeve nga Policia dhe vendimit të Gjykatës ka dalë i pafajshëm dhe është konstatuar se ka qenë montazh si postim. Dalibori

ka qenë i propozuar nga ne edhe në mandatin tonë të parë, pas miratimit të vendimit të kuvendit komunal, i është montuar ai postim në rrjetet sociale e i cili vullnetarisht ka dhënë dorëheqjeje, e që rasti është trajtuar përmes Policisë dhe Gjykatës, ku edhe ka dalë të jetë i pafajshëm. Propozimi ynë është që Dalibor Filipovic të emërohet Nënkyetar i Komunës për Komunitete në Komunën e Kamenicës, faleminderit.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për:

Labinot Haxhiu – Anëtar i Kuvendit Komunal, e para nuk është e vërtetë që ka dhënë dorëheqjeje, kemi anuluar vendimin për zgjedhjen e tij si nënkryetar. E dyta deri sa nuk i takon ligjërisht që kam frikë që edhe disa vite dhe do i takoj dhe ligjërisht me regjistrimin që është duke u bërë në krejt Kosovën e në veçanti në Kamenicë. Unë mendoj që është skandaloze mos ti takoj ligjërisht dhe ju e propozoni, nuk duhet që asnjë komuniteti nuk duhet me ja pranuar të propozuarin për derisa nuk i takon. Unë mendoj që kjo nuk të bënë nder as ty personalisht e as LVV, unë mendoj që ti duhesh me u tërheq nga ky propozim, nuk jam që ata mos të kenë nënkryetar prej vullnetit tonë të përgjithshëm por jo Dalibor Filipovic, e njeh kompjuterin nivelin e Daliborit të jetë Nënkyetar, ju mund ti keni pritshmërit për toke, përderisa e ke emëruar Arta Bajralija nënkryetare, edhe ke vendosur me porozuar Arbnoren për kryesuese të Kuvendit dhe vetën e krenon me dyjat edhe krejt këta ndihen të lumtur por dhe unë ndihna mirë që këto dyja janë në këto pozita, ama si të jetë Dalibori nënkryetar, vijën logjike a mund ta ndjekësh kryetar emërimin e Arta Bajralijut me Daliborin, i ke pritshmërit për toke kryetar pasojat do i bartësh vet por edhe të tjerët, për mua është skandal.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për:

Sejdi Kurteshi – Anëtar i Kuvendit Komunal, faleminderit kryesuese. Unë mendoj që tërë kohën ka qenë kjo nga një nënkryetar i komunitetit serb. Dalibori është shumë burrë i mirë dhe është mbështetës i madhe i Lëvizjes Vetëvendosje i keni mbet obligim në vitin 2021 e tash pas 5 vitesh po e realizoni, dhe unë jam Për kryetar.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Debati është virtyti më i lartë në Demokraci, por me thanë që nuk bënë Dalibori pa treguar se pse nuk bënë mendoj që është qesharake, ndoshta për ty është skandaloze por për mua skandaloze ka qenë emërimi i drejtorit të financave me shkollë të mesme e kjo është skandaloze, mi thanë që ku i ke 16 milion euro ti djalë me shkollë të mesme, ndërsa krejt profesionistët me shkollë të lartë me nga 20 vite përvojë pune është dashtë të jetë dikush me shkollë të mesme, mos e harro!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për një replikë, për:

Labinot Haxhiu – Anëtar i Kuvendit Komunal, unë po tentojmë të qëndrojmë në pikë, kryetar nuk të bënë nder ty me ba me gisht ose diçka, çka punon Dalibori në shkollë, se thatë që punon në Shkollë, por na trego se çfarë punon në Shkollë ?

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Dalibori thashë që punon në Shkollën “Desanka Maksimovic”, ka të regjistruar OJQ Politike, nëse ju nuk e kuptoni këtë po ta tregoj në kontestin tjetër, (ndërpret fjalën pas ndërhyrjeve).

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime të tjera ? Fjala për :

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71107041-01338-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	2053/2026
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	09.09.2026 - 10:28
Komuna / Opština / Municipality:	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Kamenicë / Kamenica / Kamenicë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta Jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pëshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71107041-01338-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shqiptare / Društvena Imovina / Socially owned Land		229			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
QENDRA TREGTARE ZEJTARE	0			


Zyrtar i përfjellës / Odgovorno lice / Official person

A.2 LLOJI I SHRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Tokë Ndërtimore/Gradëvinsko zemljište/Construction land	Shërbj-Ndërtese/Kuca-Zgrada/House-Building		229

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Identi broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Poseëdëm individual / Individualna Druzavina / Single possessor	Komuna e Kamënicës	600535390	/ / /		SKENDERBEU	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAMENICË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kamenicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71107041-01338-0	Parcelë / Parcela / Parcel	229



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1090

Punoi/Obradio/Created: Syhana Latifaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 09.09.2026

Koha/ Vreme/ Time: 10:39:41



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /
Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71107041-01339-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 2053/2026
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 09.09.2026 - 10:28
Komuna / Opština / Municipality: KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kamenicë / Kamenica / Kamenicë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Përkrahim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71107041-01339-0	PARCELE / PARCELA / PARCEL	Pronë shogërore / Društvena Imovina / Socially owned Land		5100			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
QENDRA TREGTARE ZELTARE	0			

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numbri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësore/Pojopirivredno/Agriculture	Kulllosat/Pašnjaci/pasture	Kulllosë E Klasës 4/Pasnjak 4 Klasse/4th Class Pasture	5100

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednostost adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individuealna Drzavna / Single possessor	Komuna e Kamenicës	600535390	/ / /		SKENDERBEU	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAMENICË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kamenicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m²
P-71107041-01339-0	Parcelë / Parcela / Parcel	5100



Shkalla/Razmera/Scale: 1:1079

Punoi/Obradio/Created: Syhana Latifaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 09.09.2026

Koha/ Vreme/ Time: 10:38:50



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja /
Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71107041-01336-1

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: 2053/2026
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: 09.09.2026 - 10:27
Komuna / Opština / Municipality: KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastal Zone: Kamenicë / Kamenica / Kamenicë
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastal Office: KAMENICË / KAMENICA / KAMENICË

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R GIS U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-71107041-01336-1	PARCELË / PARCELA / PARCEL	/ /	Urban	2271			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKJE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
TREBU/KAMENICA/PIJAC	0			



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m²) (m²)
1	Tokë Tjetër/Ostalo Zemljište/Otherland	Jo Pjellorë/Neplodno/Unproductive		2271

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivalište Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posëdinn individual / Indivudnaina Drzavina / Single possessor	Kommuna e Kamenicës	600535390	///		SKËNDERBEU	1/1		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAMENICË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Kamenicë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71107041-01336-1	Parcelë / Parcela / Parcel	2271



Shkalla/Razmera/Scale: 1:739

Punoi/Obradio/Created: Syhana Latifaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Data/ Data/Date: 09.09.2026

Koha/ Vreme/ Time: 10:40:29



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra e Kryetarit



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Në mbështetje të nenit 11, nenit 13, nenit 17, shkronja f), nenit 24, nenit 34 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28, datë 04.06.2008), nenit 5, nenit 6 dhe nenit 17, paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja f), nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) dhe nenit 82 të Statutit Sh.0.1.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, pas shqyrtimit të kërkesës Sh.02.Nr.24555, datë 20.08.2026, të paraqitur nga Kryetari i Këshillit Lokal të fshatit Kopërnice, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal të Komunës së Kamenicës, e cila mbahet më ____ 2026, sjell këtë:

PROPOZIM-VENDIM PËR SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT LIDHËS PËR FSHATIN KOPERNICË

1. Miratohet subvencionimi i transportit lidhës për banorët e fshatit Kopërnice, në relacionin "Varrezat e fshatit Kopërnice – dalje e fshatit Kopërnice", me gjatësi prej 2.25 km në një drejtim.
2. Linja nga pika 1 e këtij Vendimi do të shërbejë si linjë lidhëse me linjat ekzistuese të transportit të udhëtarëve që nisen nga fshati Hogosht, kalojnë nëpër fshatrat e Komunës së Kamenicës dhe vazhdojnë në drejtim të Gjilanit dhe Prishtinës, me qëllim të sigurimit të transportit për banorët e fshatit Kopërnice dhe ndërlidhjes së tyre me këto linja ekzistuese.
3. Orari i transportit lidhës do të harmonizohet me oraret e linjave ekzistuese të transportit të udhëtarëve që nisen nga fshati Hogosht, kalojnë nëpër fshatrat e Komunës së Kamenicës dhe vazhdojnë në drejtim të Gjilanit dhe Prishtinës, me qëllim të sigurimit të ndërlidhjes së banorëve të fshatit Kopërnice me këto linja të transportit.
4. Subvencionimi nga pika 1 e këtij Vendimi do të bëhet nga kategoria "Subvencione", në vlerë prej 1.10 € për kilometër të realizuar për transportin e udhëtarëve, për realizimin e katërmëdhjetë (14) udhëtimeve në ditë, përkatësisht 31.50 km në ditë, në vlerë prej 1,039.50 € në muaj dhe 12,474.00 € në vit, për periudhën tre (3) vjeçare.
5. Drejtoria e Shërbimeve Publike emëron Komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të pranura në kuadër të thirrjes publike për subvencionimin e transportit, në pajtim me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në thirrjen publike.
6. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Arsyetim

Ky Propozim-Vendim është hartuar në bazë të kërkesës Sh.02.Nr.24555, datë 20.08.2026, të paraqitur nga Kryetari i Këshillit Lokal të fshatit Kopërnice, me të cilën është paraqitur nevoja për sigurimin e transportit lidhës për banorët e këtij fshati, në relacionin “Varrezat e fshatit Kopërnice – dalje e fshatit Kopërnice”, me gjatësi prej 2.25 km në një drejtim.

Qëllimi i subvencionimit të kësaj linje është mundësimi i ndërlidhjes së banorëve të fshatit Kopërnice me linjat ekzistuese të transportit të udhëtarëve që nisen nga fshati Hogosht, kalojnë nëpër fshatrat e Komunës së Kamenicës dhe vazhdojnë në drejtim të Gjilanit dhe Prishtinës.

Transporti lidhës do të realizohet me katërmbëdhjetë (14) udhëtime në ditë, ndërsa orari do të harmonizohet me linjat ekzistuese, me qëllim që banorëve të fshatit Kopërnice t’u sigurohet transport më i përshtatshëm dhe qasje më e lehtë në rrjetin ekzistues të transportit.

Duke marrë parasysh nevojën e paraqitur dhe rëndësinë e sigurimit të transportit lidhës për banorët e fshatit Kopërnice, është propozuar miratimi i këtij Propozim-Vendimi.

Vendimi t’i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë dhe QSHQ – arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

CENTAR PËR SHËRBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./S. <u>02</u>	Nr./Br./No. <u>27265</u>
Nr. i tag Et. Str. No. Rg. <u>2</u>	Data Datum Date: <u>14/09/2026</u>
KAMENICË - KAMENICA	

Duke u bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenin 53, paragrafët 1 dhe 3 dhe nenit 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016), nenin 12, paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, si dhe në mbështetje të nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h), dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, në bazë të kërkesave për rishqyrtimin e akteve të lëshuara nga ministrinë kompetente, me numrat e protokollit 02KOMAPL 1385-1/2026, 020-476/9, 02KOMAPL 1386-1/2026, 02MAPL-1517/2026, 020-476/10 dhe 02.4548-2/26, Kryetari i Komunës së Kamenicës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës që mbahet më _____ 2026, propozon këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e vendimeve Sh.01.Nr.12089, Sh.01.Nr.17991, Sh.01.Nr.17985 dhe Sh.01.Nr.17981, Sh.01.Nr.17974, Sh.01.Nr.22376

1. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.17991, i datës 03.07.2026, për miratimin e pilot-projektit për menaxhimin e parkingut publik në Komunën e Kamenicës.
2. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.17985, i datës 03.07.2026, për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.
3. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.17981, i datës 03.07.2026, për caktimin e tarifave dhe mënyrës së inkasimit të mjeteve financiare për menaxhimin e mbeturinave.
4. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.12089, i datës 04.05.2026, për ndarjen e mjeteve financiare për shpërblimin e punëtorëve me rastin e 3 vjetorit të themelimit të NPL "Dardana" Sh.A.
5. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.17974, i datës 03.07.2026, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.
6. Shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.22376, i datës 06.08.2026, për miratimin e Vendimit për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale Nr. P-71107074-00261-1.
7. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë Vendimi Sh.01.Nr.17991, i datës 03.07.2026, Vendimi Sh.01.Nr.17985, i datës 03.07.2026, Vendimi Sh.01.Nr.17981, i datës 03.07.2026, Vendimi

Sh.01.Nr.12089, i datës 04.05.2026, Vendimi Sh.01.Nr.17974, i datës 03.07.2026, Vendimi Sh.01.Nr.22376, i datës 06.08.2026 për rishqyrtimin e akteve të lëshuara nga ministritë kompetente, me numrat e protokollit 02KOMAPL 1385-1/2026, 020-476/9, 02KOMAPL 1386-1/2026, 02MAPL-1517/2026, 020-476/10 dhe 02.4548-2/26.

8. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në përputhje me nenin 8, lidhur me nenin 9, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkyetares, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve dhe QSHQ- arkivit.

Kryetar i Komunës
Kadri Rahimaj



02 KOTAPL 1385-1/2026

8

12 07 26



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Për:	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës
Kopje:	Arbnore Beqiraj-Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jetoa Qela, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Hysni Mehani, Zv Ministër në Ministrinë e Financave
Nga:	Artur Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave Bora Duli, U.d. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave
Zyrtarët përgjegjës:	<i>[Signature]</i> <i>[Signature]</i> 14.07.2026
1. Zyrtari hartues i Marrëveshtjes ligjor	Medina Milaku, Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave
2. Zyrtari konfirmues i Marrëveshtjes ligjor	Kimete Zekaj, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave
Lënda:	Kthim në rivendosje
Lloji i aktit:	Vendim

Uderuari Kryetar z. Rahimaj.

Uderuar Kryesuese znj. Beqiraj-Fera.

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive; Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

<i>Vendimi Sh.01.Nr.17991 për miratimin e pilot-projektit për menaxhimin e parkingut publik në Komunën e Kamenicës.</i>
<i>I miratuar më datë 30.06.2026</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 06.07.2026</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave më datë 08.07.2026</i>

Ministria e Financave (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Kamenicës, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Kamenicës, me anë të aktit administrativ komunal synon miratimin e pilot-projektit për menaxhimin e parkingut publik në Komunën e Kamenicës.
2. Gjatë marrjes së këtij Vendimi, komunat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Në këtë drejtim, theksohet se kjo Rregullore, në përmbajtjen e saj, rregullon edhe çështje të tjera materiale dhe administrative; megjithatë, ky shqyrtim kufizohet ekskluzivisht në vlerësimin e saj nga aspekti i taksave komunale, përkatësisht nga këndvështrimi financiar.
3. Me relevancë për shtjellimin e kësaj çështjeje, Kreu II i Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal rregullon kompetencën e komunave për përcaktimin dhe vjeljen e taksave komunale. Në këtë drejtim, neni 13, paragrafi 1, përcakton se komuna mund të vendosë, përmes rregullore, një skemë tarifore për taksat që caktohen për shërbimet që u ofrohen personave nga komuna. Po ashtu, neni 15 i po këtij ligji autorizon komunën të përcaktojë dhe të vjelë taksat edhe për aktivitete të tjera, duke përfshirë parkimin e automjeteve në pronën komunale, përfshirë trotuarët dhe rrugët. Dispozitat relevante parashohin si në vijim:

Neni 13

Taksat Administrative Komunale

13.1 Përmes një rregulloreje, komuna mund të vendosë një skemë tarifore për taksat të cilat caktohen për shërbimet të cilat u ofrohen personave nga komuna.

Neni 15
Taksat tjera Komunale

Komuna mund të përcaktojë dhe të vjelë taksa në aktivitete të tjera, duke përfshirë si vijon:

a) parkimin e automjeteve në pronën komunale, duke përfshirë trotuaret dhe rrugët.



4. Për rrjedhojë, Ministria vlerëson se përcaktimi dhe vjelja e taksës për parkimin publik nuk mund të rregullohen përmes një vendimi komunal, por duhet të bëhen përmes një rregulloreje komunale, të miratuar në përputhje me procedurat dhe kompetencat e përcaktuara me Ligjin Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Andaj, Ministria rekomandon që komuna ta harmonizojë aktin administrativ me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke e rregulluar çështjen e përcaktimit dhe vjeljes së taksës për parkim përmes një rregulloreje komunale.
5. Si përfundim, dhe duke marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria e Financave evidenton se akti komunal i komunës së Kamenicës është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, andaj Ministria rekomandon që komuna ta harmonizojë aktin administrativ me kërkesat e legjislacionit në fuqi, duke e rregulluar çështjen e përcaktimit dhe vjeljes së taksës për parkim përmes një rregulloreje komunale.

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Kamenicës ndërmartjen e veprimeve konkrete, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit, në mënyrë që masa e përcaktuar me aktin e komunës të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Kamenicës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Artan Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave
Kopje:	Kryetari i Komunës së Kamenicës Kryesuesja e KK - Kamenicë Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmbës:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL
Nga:	Erbil Hotemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Data: 07.07.2026 VI-020-476
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministrinë e Lëvizjes	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	
Lënda:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunale
Lloji i aktit:	Shkresë përcjellëse në MF Vendim

I nderuar Sekretar,
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar: Vendimin Sh.01.Nr.17991 për miratimin e Pilot-Projektit për menaxhimin e Parkingut Publik në Komunën e Kamenicës, i miratuar në Kuvendin e Komunës së Kamenicës dhe i nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe në nenet 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Sh.01.Nr.17991 për miratimin e Pilot-Projektit për menaxhimin e Parkingut Publik në Komunën e Kamenicës

I miratuar më datë: 30.06.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Komencës
Nr. 03.07.2026

Në bazë të nenit 12, nenit 5, shkronjat h) dhe e), neni 14, neni 16, neni 17, shkronjat l) dhe p), neni 24, neni 25 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 29/2008), neni 2, neni 4, neni 8 dhe neni 22 të Ligjit Nr. 03/L-049 për Përmirësimin e Pashallit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-108, Projekt-proponimin Sh.01.Nr.16036, datë 15.06.2026, të parashtruar nga Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë, si dhe të neni 3, paragrafi 3.7, neni 5, paragrafi 5.1, shkronjat h) dhe e), neni 57, paragrafi 57.2, shkronjat d) dhe dh), neni 28 si dhe neni 32 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamencës, Kuvendi i Komunës së Kamencës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026 miratoi këtë:

VENDIMI

Për miratimin e Pilot-Projektit për Menaxhimin e Parkimeve Publike në Komunën e Kamencës

1. Miratohet vendimi për Pilot-Projektin për menaxhimin e parkimeve publike në Komunën e Kamencës, në Rrugën "Skenderbeu", në hapësirën e parkingut "Të Gjelbër", si dhe në parkingun në Rrugën "Skenderbeu", përballë objektit të Komunës së Kamencës.
2. Pilot-Projektin zbatohet për një periudhë prej 3 (tre) muajsh, duke filluar nga data 15.07.2026 deri më 15.10.2026.
3. Tërshi e parkimit gjatë periudhës së zbatimit të pilot-projektit është 0.50 € (pesëdhjetë cent) për ydo orë parkimi.
4. Menaxhimin e parkingut publik në kuadër të pilot-projektit i jepet Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardhina" Sh.A., e cila është përgjegjëse për administrimin e parkingut, inkasimin e taksave të parkimit, tëshimin e bileteve të vlefshme dhe me numër serik, mbledhjen e evidencave përkatëse dhe mporimin periodik në formularë e projektit.
5. Drejtoria për Buxhet dhe Financa siguron billok-billoc zyrtar të vlefshme dhe me numër serik, si dhe ndërmerr veprimet e nevojshme për evidencimin dhe menaxhimin e të hyrjeve të realizuara nga pilot-projektin.
6. Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë bën shërbimin e përdorshëm të hapësirave të dedikuara për parkim dhe vendosjen e sinjalistikës së informimit të nevojshme në zonën e pilotimit.

7. Të hyrë e realizimit nga inkasimi i tarifave të parkimit (dardhen) në shkollëgjatë bankare të Komitës së Kontabilitetit dhe evidentohen si të hyra vetanake komunale, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

8. Pilot-Projekti i karakterit testues dhe ankëzës tregim të përberëshëm të menaxhimit të parkingjeve publike. Pas përfundimit të periudhës së pilotimit, rezultatet financiare dhe operative i paraqiten Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe vendimarrje të mëtejshme.

9. Për zbatimin e kësaj vendimi përgjegjëse janë Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorati dhe Emergjencë, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Ndërmarrja Publike Lokale "Dardhina" Sh.A.

10. Ky vendim hyrë në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin arhivues, në pajtim me nenin 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 001/2014 për Shqyrtimin Administrativ të Aktive të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe për shpalljen publike në mbledhje e shpalljeve ose në faqen zyrtare të Komunitetit.

Arsyetim

Me qëllim të testimit të një modeli të organizimit të menaxhimit të parkingut publik, vlerësimit të niveleve të shfrytëzimit të kapaciteteve të parkimit dhe krijimit të kushteve për realizimin e të hyrave vetanake komunale, propozohet zbatimi i një pilot-projekti në Rrugën "Skënderbeu" për një periudhë prej tre (3) muajesh.

Gjatë periudhës së pilotimit propozohet caktimi i tarifës së parkimit në vlerë prej 0.50 € për çdo orë parkimi, ndërsa menaxhimi operacional i parkingut publik t'i jepet në menaxhimin Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardhina" Sh.A. Të hyrë e realizimit nga inkasimi i tarifave do të dardhen në buxhetin e Komunitetit të Kontabilitetit dhe do të evidentohen si të hyra vetanake komunale.

Pas përfundimit të periudhës së pilotimit, rezultatet e projektit do t'i paraqiten Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe vendimarrje të mëtejshme.

Për arsyet e paraqitura më sipër, propozohet që Kuvendi Komunal i Komitës të miratojë këtë Propozim-Vendim.


Vendimi u dërgohet: Zyres së Kryetarit, Zyres së Ndihmës Kryetarit, Shërbimit Profesional të Kuvendit, Drejtorisë Komandante, Zyres për Përkthime, Zyres së Informimit, APL-së dhe QSHQ - Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Arbore BISHRI



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komiteti e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamërica Municipality



Nr. 002 datë 15.06.2026

PROJEKT-PROPOZIM

Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë

Data: 15.06.2026

Për:

z. Kadir Rahimaj Kryetar Komitete të Kamenicës
zaj. Ardit Bajrami Kryetar Komitete të Kamenicës

Ngr. Z. Zefir J. J. Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe
Emergjencë

Libri: Kamenica dhe Pili-Projekti për menaxhimin e parkimeve publike

Indermir Ketyre,
E ndihmues Kryesues,

Nëmbështetje të nenit 16, nenit 17, shkronjat 1) dhe 2), si dhe nenit 24 të Ligjit Nr. 031/-040 për
Veçqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës, si dhe dispozitiveve përkatëse të legjislacionit në
fuqi që rregullojnë menaxhimin e hapësirave publike dhe realizimin e të hyrave komunalë,
Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencë paraqet për shqyrtim dhe
miratim këtij projekt-proponim për realizimin e një pilot-projekti për menaxhimin e dy parkimeve
publike në territorin e Komitete të Kamenicës.

Aktualisht, Komiteti e Kamenicës nuk realizon të hyrat nga shfrytëzimi i parkimeve publike,
ndërsa në zonat më frekuentin më të lartë parashihet vëzhgimi në menaxhimin dhe shfrytëzimin
slikës të hapësirave publike të dedikuara për parkim. Për këtë arsye, propozohet zbatimi i një pilot-
projekti me (3) naqer me qëllim:

- Vlerësimin e nivelit të shfrytëzimit të kapaciteteve eksistuese të parkimeve publike;
- Testimin e modelit të administrimit dhe pagesës së shërbimit të parkimit;
- Krijimin e një skemë të organizimit për menaxhimin e hapësirave publike të dedikuara për
parkim;
- Mësimet dhe të dhënat financiare dhe operativë të nevojshme për hartimin e politikave dhe
niveleve komunalë për menaxhimin dhe shfrytëzimin e parkimeve publike.

Të dhënat kryesore të pilot-projektit janë si më vijim:

- Zona e pilotimit: Rruga "Skënderbeu", në hapësirën e parkingut "Të Gjellës", si dhe parkingu në Rrugën "Skënderbeu", përballë objektit të Komunës
- Kohëzgjatja: 3 (tre) muaj, nga 15.07.2026 deri më 15.10.2026;
- Orari i aplikimit: nga 6 hëra deri të shtunën, prej orës 08:00 deri në mbr 20:00, ndërsa të dielën prej orës 08:00 deri në orën 16:00;
- Tafalet e propozuara: 0.50 € për çdo orë parking;

Pagesat do të realizohen në përputhje me procedurat e përcaktuara për këtë pilot-projekt dhe do të evidentohen përmes dokumentacionit përkatës financiar.

Për realizimin e pilot-projektit, menaxhimi operacional i parkingjeve publikë propozohet të kryhet nga Ndërmarrja Publike Lokale "Dardana" Sh.A., e cila do të jetë përgjegjëse për ndërtimin e hapësirave të përcaktuara në projekt, inkasimin e tarifave të parkingut, lëshimin e biletave të vlefshme dhe me anëtarë të sigurt nga Komuna e Kamenicës, evidentimin e pagesave, mbajtjen e evidencave përkatëse dhe raportimin periodik mbi rezultatet operative dhe financiare të projektit.

Për nevojat e zbatimit të projektit, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave do të sigurojë biletë-biletë të vlefshme dhe me numër serik mbi, të cilat do të përdoren për evidentimin dhe konfirmimin e pagesave të realizuara gjatë periudhës së pilotimit.

Të hyrat e realizuara nga inkasimi i tarifave të parkingut do të derdhen në shërbimet hapëse të Komunës së Kamenicës dhe do të evidentohen si të hyra vjetërore komunale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat financiare të aplikueshme.

Duke marrë parasysh rëndësinë e krijimit të një sistemi funksional, transparent dhe të qëndrueshëm për menaxhimin e parkingjeve publike, kërkojmë që ky projekt-propozim të shqyrtohet dhe të miratohet, si dhe të autorizohen drejtorit dhe organet kompetente për ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme për zbatimin e tij.

Më respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Kadri Rrahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Arbnore Beqiraj Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kamenicës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbilin Hefemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL	Datë: 24.07.2026 -VI-020-476
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Sh.01Nr.17985 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës
I miratuar më datë: 30.06.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIMI


MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026 ka miratuar Vendimin Sh.01Nr.17985 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.17985 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, është në kundërshtim me nenin 17, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019), i cili përcakton se: *"Për secilin vendim paraparak të Kuvendit të Komunës formohet komisioni vlerësues"*.

Në rastin konkret, nuk është përcaktuar saktë se për cilin vendim paraparak është formuar komisioni, po ashtu vlen të ceket se pronat për të cilat është formuar komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, Vendimi Sh.01Nr.17974 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, për parcelën kadastrale P-71107041-01336-1, parcelën kadastrale P-71107041-01338-0, parcelën kadastrale P-71107041-01339-0, parcelën kadastrale P-71107041-01335-0 është në kundërshtim me Listën e veçantë Sh.02Nr.2258 të pronave të paluajtshme komunale për vitin 2026 të Komunës së Kamenicës. Përkatësisht afati i dhënies në shfrytëzim për parcelat kadastrale në vendim është përcaktuar afatshkurtër në kohëzgjatje prej 10 vite, ndërsa në listën e pronave afati i dhënies në shfrytëzim është përcaktuar afatgjatë 15-99 vite.


Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kamenicës duhet të ndërmerri veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 03.07.2026

Bazuar në 12 paragrafi 2 shkronja d), neni 14 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008), nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1; nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 14 dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, nenin 6, paragrafi 3, nenin 8 dhe 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunalë si dhe nenin 3, paragrafi 3.7, nenin 5, paragrafi 5.1 shkronja h) nenin 38 dhe neni 82 të Statutit 01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.06.2026 miratoi këtë:

VENDIM


PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS


1. Miratohet vendimi për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të pronave të paluajtshme të komunës, me numër të parcelave:
 - 1.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01336-1 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Tregu", në sipërfaqe të përgjithshme prej 2271m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Kamenicës.
 - 1.2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01338-0 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Qendra Tregtare Zejtare", në sipërfaqe të përgjithshme prej 229m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Kamenicës.
 - 1.3. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01339-0 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Qendra Tregtare Zejtare", në sipërfaqe të përgjithshme prej 5100m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Kamenicës.
 - 1.4. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01335-0 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Pran Tregu", në sipërfaqe të përgjithshme prej 249m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Kamenicës.

2. Komisioni nga pika 1 (një) e këtij vendimi ka këtë përbërje:
 - 2.1. Liridon Kastrati, anëtar i kuvendit,
 - 2.2. Magbule Kastrati, anëtare e kuvendit,
 - 2.3. Enis Fazliu nga ekzekutivi i komunës,
 - 2.4. Liridon Rexhepaj nga ekzekutivi i komunës,
 - 2.5. Lavdim Klaiqi nga sektori joqeveritar lokal
3. Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 10 vite.
4. Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.
5. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën (2) dy të këtij Vendimi, përgjegjësitë dhe kompetencat do të ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
6. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastër të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimit të kontratës pas lidhjes së sajë.
7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Komisionit.
8. Kuvendi i Komunës së Kamenicës e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
9. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit bëhet zyrtar në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkryetares, Shërbimit Profesional të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorive Komunale, Anëtarëve të Komisionit, MAPL-së dhe QSHQ- arkivi.

Kryesuese e Kuvendit Komunal


Arbore BEQIRAJ FERA



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarsvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Kadri Rrahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Arbuore Beqiraj Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kamenicës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erbilin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor MAPL	Date: 24.07.2026 -VI-020-476
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Sh.01Nr.17985 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës
I miratuar më datë: 30.06.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARGUMENTIM


MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026 ka miratuar Vendimin Sh.01Nr.17985 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.17985 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, është në kundërshtim me nenin 17, paragrafi 6, të Ligjit Nr. 06/1-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/03 Prill 2019), i cili përcakton se: *"Për secilin vendim paraprak të Kuvendit të Komunës formohet komisioni vlerësues"*.

Në rastin konkret, nuk është përcaktuar saktë se për cilin vendim paraprak është formuar komisioni, po ashtu vlen të ceket se pronat për të cilat është formuar komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, Vendimi Sh.01Nr.17974 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, për parcelën kadastrale P-71107041-01336-1, parcelën kadastrale P-71107041-01338-0, parcelën kadastrale P-71107041-01339-0, parcelën kadastrale P-71107041-01335-0 është në kundërshtim me Listën e veçantë Sh.02Nr.2258 të pronave të paluajtshme komunale për vitin 2026 të Komunës së Kamenicës. Përkatësisht afati i dhënies në shfrytëzim për parcelat kadastrale në vendim është përcaktuar afatshkurtër në kohëzgjatje prej 10 vite, ndërsa në listën e pronave afati i dhënies në shfrytëzim është përcaktuar afatgjatë 15-99 vite.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kamenicës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republiken Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenica
Nr. 03/07.2020

Bazuar në 12 paragrafi 1 shkronja d), nenin 14 dhe 40 të Ligjit Nr. 06/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 26, publikuar më 4 qershor 2008), nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1; nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 14 dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Përhijitshme të Komunës, nenin 5, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, nenin 6, paragrafi 3, nenin 8 dhe 17 të Rregullores (ORR) Nr. 09/2020 për Përzaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komonale si dhe nenin 3, paragrafi 3.7, nenin 5, paragrafi 5.1 shkronja h) nenin 38 dhe nenin 82 të Statutit 01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.06.2023 miratoi këtë:

VENDIMI

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE DHE VLERËSIMIN E OFERTAVE TË DHËNIES NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUJTTSHME TË KOMUNËS

1. Miratohet vendimi për formimin e Komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, deri në 15 (pësnmbëdhjetë) vite, të pronave të përhijitshme të komunës, me numër të parcelave:
 - 1.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01336-1 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Tregu", në sipërfaqe të përgjithshme prej 2271m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Kamenicës.
 - 1.2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01338-0 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Qendra Tregtare Zejtare", në sipërfaqe të përgjithshme prej 229m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Kamenicës.
 - 1.3. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01339-0 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Qendra Tregtare Zejtare", në sipërfaqe të përgjithshme prej 5100m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Kamenicës.
 - 1.4. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01335-0 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Pran Tregu", në sipërfaqe të përgjithshme prej 249m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Kamenicës.

3. Komisioni nga pika 1 (një) e këtij vendimi ka këtë përbërje:

- 3.1. Liridon Kasirafi, anëtar i Kuvendit,
- 3.2. Atangbule Kasirafi, anëtare e Kuvendit,
- 3.3. Enis Fazliu nga ekzekutivi i Komunës,
- 3.4. Liridon Rexhepi nga ekzekutivi i Komunës,
- 3.5. Lavdim Klajqi nga sektori joqeveritar lokal

- 3. Afili kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komonale është afatshkurtër me kohëzgjatje prej 10 vite.
- 4. Anëtarët e komisionit me shumicë të votave zgjedhin Kryesuesin e Komisionit, i cili kryeson punën e komisionit.
- 5. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën (2) dy të këtij Vendimi, përgjegjësit dhe kompetencat do t'i ushtroj në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës dhe Rregullores së QRK Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
- 6. Obligohet Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës që të zhvilloj procedurat për shpalljen e Ankandit, si dhe Drejtoria për Pronë Gjeodezi dhe Kadastr të bëjë përditësimin dhe mirëmbajtjen e listës, pas përfundimit të procedurave të ankandit dhe menaxhimin e kontratës pas lidhjes së sajë.
- 7. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Komisionit.
- 8. Kuvendi i Komunës së Kamenicës e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdo herë që kërkohet.
- 9. Ky vendim hyj në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit bëhet zyrtar në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkryetares, Shërbimit Profesional të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë Komunale, Anëtarëve të Komisionit, MAPL-së dhe QSHQ- arkivi.

Kryesuese e Kuvendit Komunal

Arbnor BEQIRI JERA

02K/APL 1386-1/2026

17.07.26



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Për:	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës
Kopje:	Arbnore Beqiraj-Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësi për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmbledh:	Hysni Mehani, Zv.Ministër në Ministrinë e Financave
Ngo:	Artan Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave Bora Duli, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave
Zyrtarët përgjegjës	<i>[Signature]</i> Bora Duli
1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Medina Mllaku, Zrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave
2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Kimete Zekaj, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave <i>[Signature]</i>
Referencë:	151/2026
Udhëzimi:	Kthim në rivendosje
Udhëzimi i aktit:	Vendim

I nderuari Kryetar z. Rahimaj,
E nderuar Kryesuese znj. Beqiraj-Fera.

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

<i>Vendimi Sh.01.Nr.17981 për caktimin e tarifave dhe mënyrës së inkasimit të mjeteve financiare për menaxhimin e mbeturinave.</i>
<i>I miratuar më datë 30.06.2026</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 06.07.2026</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave më datë 08.07.2026</i>

Ministria e Financave (këtej e tutje referuar si "**Ministria**"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Kamenicës, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Kamenicës, me anë të aktit administrativ komunal synon miratimin e Vendimit për caktimin e tarifave dhe mënyrës së inkasimit të mjeteve financiare për menaxhimin e mbeturinave.
2. Gjatë marrjes së këtij Vendimi, komunat obligohen t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal. Në këtë drejtim, theksohet se kjo Rregullore, në përmbajtjen e saj, rregullon edhe çështje të tjera materiale dhe administrative; megjithatë, ky shqyrtim kufizohet ekskluzivisht në vlerësimin e saj nga aspekti i taksave komunale, përkatësisht nga këndvështrimi financiar.
3. Me relevancë për shtjellimin e kësaj çështje, Kreu II i Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal ka përcaktuar se është në diskrecion të komunave që të vendosin lirshëm në lidhje me përcaktimin e taksave komunale dhe në rast të përcaktimit të tyre, kjo duhet të bëhet përmes rregulloreve komunale. Neni 13 paragrafi 1 i Ligjit Nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, ka paraparë si në vijim:

Neni 13

Taksat Administrative Komunale

13.1 Përmes një rregulloreje, komuna mund të vendosë një skemë tarifore për taksat të cilat caktohen për shërbimet të cilat u ofrohen personave nga komuna.

4. Për njëdhjetë, Ministria vlerëson se përcaktimi dhe vjelja e taksës për menaxhimin e mbeturinave nuk mund të rregullohen përmes një vendimi komunal, por duhet të bëhen përmes një rregulloreje komunale, të miratuar në përputhje me procedurat dhe kompetencat e



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Municipality




Kuvendi i Komunës-Komunele
Nr. 03.07.2026
Në bërje të numrit 12, mbi 17, mbledhjen e 17, datë 17.06.2026, në verë të tërës
("Chyza e Zyrës e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008); numri 13, paragrafi 2 dhe 15,
paragrafi 1, në paragrafi 1.1, dhe numri 34, paragrafi 9 të Ligjit Nr. 08/L-071, Vendi Nr. 04/L-060 për mbeturinat,
përfshirë dhe përfshirë me Ligjin Nr. 08/L-071, Vendi Nr. 04/L-060, datë 17.04.2026
Për: Kuvendi i Grupit Komunal për mbeturinat e trashëguara për shërbimet e menaxhimit të
mbeturinave, si dhe numri 5 paragrafi 5.1 në 38 dhe numri 12 të Statutit Sh.01.Nr.202023, të datës
21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e
mbledhur me datë: 30.06.2026 mbledhur tërë;

VENDIMI

Për caktimin e tarifave dhe mënyrën e llogaritjes të mjeteve financiare për menaxhimin e
mbeturinave

1. Miratohet vendimi për caktimin e tarifave për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave në
territorin e Komunës së Kamenicës, sipas kategorive të përcaktuara në Shitjeën
Sh.01.Nr.16620, datë 15.06.2026, e cila i bashkëngjitet dhe është pjesë e kësaj vendimi.
2. Tarifat, kategoritë e gjerësisë dhe mënyra e llogaritjes të mjeteve financiare për shërbimet
e menaxhimit të mbeturinave përcaktohen në Shitjeën Sh.01.Nr.16620, datë 15.06.2026, e
cila përmban rregullat për ofrimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave, llogaritjes e
shërbimit të kontajnerëve, obligimet e shfrytëzuesve të shërbimit, si dhe mënyrën e aplikimit,
në llogaritjes dhe arsyetimit të të hyrave.
3. Shitja Sh.01.Nr.16620, datë 15.06.2026, është pjesë integrale e kësaj vendimi.
4. Ky Vendim hyi në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbledhës, në pajtim
me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shërbimin Administrativ të Aktëve të
Komunave, si dhe për publikimin në tabelën e shpalljeve ose në tregun zyrtar të Komunës.

Vendimi u dërgohet: Zyres së Kryetarit, Zyres së Menaxhimit, Shërbimit Profesional të
Kuvendit, Drejtorisë Komunalë, Zyres së Informimit, Zyres për përkrahje, MAF-së dhe QSHQ-
Arkipit





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Për: **Kadri Rahimaj**, Kryetar i Komunës së Kamenicës

Kopje: **Arbnore Beqiraj-Fera**, Kryesuese e Kuvendit të Komunës
Elbert Krasniqi, Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Përmes: Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Hysni Mehani, Zy. Ministër në Ministrinë e Financave

Nga: **Arton Ahmeti**, Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave
Bora Duli, U.d. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor, Ministria e Financave Datë: 10.08.2026

Zyrtarët përgjegjës: **Medina Miliaku**, Zyrtare e Lartë Ligjore për Hartim të Legjislacionit, Departamenti Ligjor, Ministria e Financave Referencë: 190/2026

1. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor

2. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor **Kimete Zekaj**, Udhëheqëse e Divizionit për Politika Buxhetore, Ministria e Financave

Lënda: **Kthim në rivendosje**

Lloji i aktit: **Vendim**

I nderuari Kryetar z. Rahimaj,
E nderuar Kryesuese znj. Beqiraj-Fera,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

<i>Vendimin Sh.01.Nr.12089 për ndarjen e mjeteve financiare për shpërblimin e punëtorëve me rastin e 3-vjetorit të themelimit të NPL "Dardania" Sh.A.</i>
<i>I miratuar më datë 04.05.2026</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 28.07.2026</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave më datë 29.07.2026</i>

Ministria e Financave (këtej e tutje referuar si "Ministria"), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Kamenicës, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Kamenicës, me anë të aktit administrativ komunal synon ndarjen e mjeteve financiare për shpërblimin e punëtorëve me rastin e 3-vjetorit të themelimit të NPL "Dardania" Sh.A.
2. Në shqyrtimin e mundësisë së Komunës për realizimin e aktit administrativ komunal, Ministria ka konsultuar Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-21 (këtej e tutje referuar si "LMFPP"). Po ashtu, është konsultuar Ligji Nr. 10/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026.
3. Kështu, pas shqyrtimit të legjislacionit në fuqi, Ministria konstaton se nuk ekziston bazë ligjore që i mundëson Komunës ndarjen e mjeteve financiare nga buxheti komunal për qëllime të shpërblimin të punëtorëve të ndërmarrjeve lokale publike. Në këtë kuptim, shpenzimi i mjeteve publike për shpërblimin e punëtorëve të NPL "Dardania" Sh.A., me rastin e 3-vjetorit të themelimit të kësaj ndërmarrjeje, nuk mbështetet në ndonjë dispozitë të legjislacionit financiar në fuqi dhe, rrjedhimisht, nuk mund të realizohet nga buxheti i Komunës.
4. Rrjedhimisht, akti administrativ i Komunës së Kamenicës është nxierrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Kamenicës ndërmarrjen e veprimeve konkrete, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit, në mënyrë që masa e përcaktuar me aktin e komunës të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Kamenicës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave



02/MAPL

1517/2026

29 07 26

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

Për:	Arton Ahmeti, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Kamenicës Kryesuesja e KK - Kamenicë Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hefemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunalet dhe Akteve të Kryetarit	
1. Zytari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve Komunalet	
2. Zytari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Shkresë përcjellëse në MF	
Lënda:	Vendim	
Lloji i aktit:	Vendim	

Data: 28.07.2026
VI-020-355/5

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Sh.01.Nr.12089 për ndarjen e mjeteve financiare për shpërblimin e punëtorëve me rastin e 3-vjetorit të themelimit të NPL "Dagdana" Sh.A., i miratuar në Kuvendin e Komunës së Kamenicës dhe i nënshkruar nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe në nenet 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Sh.01.Nr.12089 për ndarjen e mjeteve financiare për shpërblimin e punëtorëve me rastin e 3-vjetorit të themelimit të NPL "Dagdana" Sh.A.

I miratuar më datë: 04.05.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 28.07.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komiteti Komunal-Kamenicë
NR: 07.05.2026

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d), 17 shkronja e) dhe f), si të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), dispozitive të Ligjit Nr. 03/L-040 për Financat e Pashmërit Lokal, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-101 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-040 për Financat e Pashmërit Lokal, nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimit Komunal Sh.01.Nr.27697, të datës 30.09.2025, për miratimin e Buxhetit Komunal për vitin 2026 dhe parashikimin për vitet 2027-2028, Vendimin Nr. 07/165, datë 12.10.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A., të Kushtesës Sh.02.Nr.8492, të datës 01.04.2026, të paraqitur nga Kryeshafi Ekzekutiv i NPL "Dardana" Sh.A., si dhe në bazë të nenit 30 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komitës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 04.05.2026 miratoi të tjerë:

V E N D I M I
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR SHPËRBLIMIN E PUNËTORËVE
ME RASTIN E 3-VJETORIT TË THEMELIMIT TË NPL "DARDANA" SH.A.

1. Miratohet vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 3,000.00 € (tre mijë euro) për Ndërmarrjen Publike Lokale "Dardana" Sh.A., në bazë të Kushtesës Sh.02.Nr.8492, të datës 01.04.2026, të paraqitur nga Kryeshafi Ekzekutiv i NPL "Dardana" Sh.A.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1 të këtij vendimi destinohen për shpërblimin e punëtorëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A., si shenjë mirënjohjeje për kontributin e tyre të vazhdueshëm që nga themelimi i ndërmarrjes.
3. Shpërblimi nga pikë 2 e këtij vendimi ndahet me rastin e shënimit të 3-vjetorit të themelimit të Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A.
4. Obligohet menaxhmenti i NPL "Dardana" Sh.A. që shumën e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi ta shpërndajë tek punëtorët në formë të shitesave apo shpërblimeve mbi pagë, duke ekzekutuar në llogaritë e tyre bankare.
5. Bashkangjitur këtij vendimi është kërkesa Sh.02.Nr.8492, e datës 01.04.2026, e paraqitur nga Kryeshafi Ekzekutiv i NPL "Dardana" Sh.A.
6. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Aktëve të Komunave, dhe pas publikimit në listën zyrtare të ueb-faqes zyrtare të Komunës.

Arsyetimi

Ndërmarrja Publike Lokale "Dardana" Sh.A., që nga themelimi i saj, ka lanjtur një rol të rëndësishëm në ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve komunale për qytetarët e Komunës së Kamennicës. Gjatë periudhës tërësore të funksionimit, kjo ndërmarrje ka kultivuar fuqia të rëndësishme të konsolidimit organizativ, zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe ngritjes së cilësive të shërbimeve publike.


Duke u bazuar në kërkesën Sh.02.Nc.8492, të datës 01.04.2026, të parashit nga Kryeshefi Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A., si dhe duke marrë parasysh angazhimin dhe kontributin e vazhdueshëm të punëtorëve në funksionimin dhe zhvillimin e ndërmarrjes, Komuna e Kamennicës vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme ndarjen e mjeteve financiare për shpërbëimin e tyre.

Ky shpërbëim ka për qëllim të shpikë mirënjohjen institucionale për përkushtimin, përgjegjëshmërinë dhe profesionalizmin e treguar nga stafi i ndërmarrjes, sidomos gjatë fazës fillestare të funksionimit, e cila karakterizohet me sfida të shumta në organizim dhe operim. Ngjykoftësit, kjo merrë synon të ndikojë pozitivisht në motivimin e mëtejshëm të punëtorëve, në rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të performancës në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.


Ndarja e mjeteve financiare për këtë qëllim është në përputhje me prioritetet e Komunës për forcimin e ndërmarrjeve publike lokale dhe përmirësimin e shërbimeve publike, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësive të jetës për qytetarët.

Vendim i u dërgohet Zyrtës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Ndërmarrjes Publike Lokale "Dardana" Sh.A, Drejtoritve komunale, BAPL-së, QSHO - Arkivit.

Kryeshefi i Kuvendit Komunal
[Signature]
Arbnor BEQIRI BERA



NDËRHIMARRJA
PUBLIKE
BARDANA



NDËRHIMARRJA PUBLIKE LOCALE "BARDANA" SH.L. KRAJINORË

REFERENCË:	Nr.02/64
PLUZA/TO:	Zyrtërisht kryetari i Kuvendit Komunal Komentez,
CP:	
NGA/OD.ROM:	Gazetari Mavris, Kryetari i Ekzekutiv
TEMA/SUBTEMA/SUBTEMA:	Kërkesë për elizhësi dhe shpërndarje në vlerë prej 3,000
Lidhjetoni	Komentez
Data:	01.01.2026

I nderuar Kryetar i Komandës, z. Karel Raftonaj,

Tu informojmë se Kuvendi Komunal,

Përmes kësaj kërkesë, dëshirojmë t'ju drejtojmë me respekt për të kërkuar elizhësin dhe shpërndarjen në vlerë prej 3,000 (tre mijë) euro.

Kjo kërkesë bëhet me rastin e përfundimit të tyre të themelimit të ndërmarrjes së re, gjatë së cilës përvojat e kënaqësive të kontributit të sigurojnë punën për 23 punëtorë. Ky përfundim paraqet një moment të rëndësishëm për ne, duke reflektuar angazhimin, përkushtimin dhe aftësinë e realizimit gjatë kësaj periudhe. Përkundër sfida të ndryshme ekonomike, kemi vazhduar të opërojmë me përkushtim, duke marrur vendet dhe duke ofruar shërbime cilësore.

Mbështetja juaj do të kishë një ndikim të drejtpërdrejtë në stabilitetin financiar të ndërmarrjes së re dhe në mirëqenien e punëtorëve tanë, duke na mundësuar të vazhdojmë aktivitetin tonë dhe të kontribuojmë në komunitet.

Shpresojmë të mirëkuptohet dhe përshihet tuf për këtë kërkesë të nryeshme.

Ju falënderojmë për përkrahjen dhe mbështetjen tuaj.

Me respekt,



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministrtstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Kadri Rrahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës Arbnore Beqiraj Fera, Kryesuesë e Kuvendit të Komunës së Kamenicës
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmbes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
Nga:	Erbil Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL
Zyrtarët përgjegjës:	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Kuvendeve Komunale dhe Akteve të Kryetarit
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës
Lënda:	Kërkesë për Rishqyrtim
Lloji i aktit:	Vendim

Date: 20.07.2026
-VI-020-476

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Sh.01Nr.17974 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik
I miratuar më datë: 30.06.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.07.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

ARSYETIM

MAPL, konstaton se Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026 ka miratuar Vendimin Sh.01Nr.17974 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik.

MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.17974 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, është në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 6 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili përcakton se: *"Kryetari i Komunës i propozon për miratim paraparak Kuvendit të Komunës pronën e paluajtshme të komunës për dhënien në shfrytëzim"*.

Në rastin konkret titulli i Vendimit i cili propozohet për miratim në Kuvend të Komunës duhet të jetë: Vendim paraparak Sh.01.Nr. _____ për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës.


Po ashtu MAPL, konstaton se Vendimi Sh.01Nr.17974 për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik, për parcelën kadastrale P-71107041-01336-1, parcelën kadastrale P-71107041-01338-0, parcelën kadastrale P-71107041-01339-0, parcelën kadastrale P-71107041-01335-0 është në kundërshtim me Listën e veçantë Sh.02Nr.2258 të pronave të paluajtshme komunale për vitin 2026 të Komunës së Kamenicës. Përkatësisht afati i dhënies në shfrytëzim për parcelat kadastrale në vendim është përcaktuar afatshkurtër në kohëzgjatje prej 10 vite, ndërsa në listën e pronave afati i dhënies në shfrytëzim është përcaktuar afatgjatë 15-99 vite.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Kamenicës duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kaménica
Municipality of Kamenicë

Kuvendi Komunal-Kamenicë
Nr: 03.07.2026

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shikronja d), nenit 14 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr.28 Publikuar më 4 qershor 2008), nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenit 14 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, nenit 6 paragrafi 3, nenit 8 dhe 17 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës Komunale, si dhe nenit 3, paragrafi 3.7, nenit 5, paragrafi 3.1, shikronja h), nenit 38 dhe nenit 32 të Statutit 01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.06.2026 miratoi këtë:


VENDIMI

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE PËRMES ANKANDIT PUBLIK

1. Miratohet vendimi për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Kamenicës personave fizik dhe juridik si në vijim:
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, sipas nenit 1 të këtij vendimi janë:
 - 1.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01336-1 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Tregu", në sipërfaqe të përgjithshme prej 2271m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Kamenicës.
 - 1.2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01338-0 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Qendra Tregtare Zejtare", në sipërfaqe të përgjithshme prej 229m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Kamenicës.
 - 1.3. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01339-0 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Qendra Tregtare Zejtare", në sipërfaqe të përgjithshme prej 5100m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Kamenicës.
 - 1.4. Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71107041-01335-0 në zonën kadastrale Kamenicë, në vendin e quajtur "Pran Tregu", në sipërfaqe të përgjithshme prej 249m², e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Kamenicës.

- Vendimi u dërgohet: Zyres së Kryetarit, Zyres së Nënkrutares, Shërbimit Profesional të Kuvendit, Drejtorit të Komunalë, Zyres së Informimit, Zyres së Përkthimeve, MAPL-së dhe OSIF – arkiv.*

Архив: ВЕОМ/ИР/



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Për:	Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës së Kamenicës
Kopje:	Arbnore Beqiraj Fera, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Kamenicës Elbert Krasniqi, Ministër në detyrë në MAPL
Përmes:	Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Fitore Pacolli Dajpi, Ministre në detyrë në MMPH
Nga:	Bajram Kafexholli, U.D-Sekretar i Përgjithshëm në MMPH Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor në MMPH
Zyrtarët përgjegjës:	Arta Krasniqi - Zyrtare e Lartë Ligjore në Divizionin për Bashkëpunim Ndërinstitucional në Fushën e Përfaqësimeve Gjyqësore dhe Koordinim të Marrëveshjeve
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit
Lloji i aktit:	Vendim nr.01-22376 për miratimin e Vendimit për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale nr. P-71107074-00261-1, e cila sipas Planit Zhvillimor Komunal evidentohet si "zone minerare", në "tokë industriale", I miratuar nga Kuvendi I Komunës së Kamenicës

I nderuar kryetar Rahimaj,
E nderuar kryesuese Beqiraj Fera

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), në pajtim me nenin 9 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 10.08.2026 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Vendimin nr.01-22376 për miratimin e Vendimit për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale nr. P-71107074-00261-1, e cila sipas Planit Zhvillimor Komunal evidentohet si "zone minerare", në "tokë industriale", I miratuar nga Kuvendi I Komunës së Kamenicës

MMPH pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me nenin 8, 9 dhe 10 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave kërkon nga Kuvendi Komunal i Kamenicës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimit nr.01-22376 për miratimin e Vendimit për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale nr. P-71107074=00261-1, e cila sipas Planit Zhvillimor Komunal evidentohet si "zone minerare", në "tokë industriale"

ARSYETIMI

MMPH pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Vendimi në preambulë është thirrur në nenin 6, Nenin 10 dhe 11 të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, në këto të cilat nuk kanë të bëjnë me "*ndryshimin e destinimit*".

Neni 6 përcakton Subjektet përgjegjëse të Planifikimit Hapësinor, Neni 10 përcakton Përgjegjësitë e Kuvendit Komunal në Planifikimin Hapësinor që kanë të bëjnë kryesisht me aprovimin e Vendimeve për hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor të nivelit lokal në fazat e caktuara, dhe Neni 11 Përgjegjësitë e Autoritetit Përgjegjës Komunal për Planifikim dhe Menaxhim Hapësinor, ku përcaktohen përgjegjësitë për zhvillimin hapësinor, përmes hartimit dhe zbatimit të qëllimeve dhe objektivave të deklaruara në dokumentet e planifikimit hapësinor, dhe procedurat që duhet ndjekur për hartimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor të nivelit lokal.

Sipas Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor "*ndërrimi i destinimit*" apo shfrytëzueshmëria e lokacionit përcaktohet me dokument të planifikimit hapësinor, prandaj nuk lejohet destinim apo shfrytëzueshmëri tjetër nga ajo që është e paraparë me dokumentet e planifikimit hapësinor (pjesën tekstuale dhe pjesën grafike) në fuqi.


Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPH, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Ligjit Nr. 08/ L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregullores (Qrk) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal në Kamenicë
Më: 05.08.2026

Në mbështetje të nenit 5, shkronja b), neneve 11, 12, paragrafëve 12.1 dhe 12.2, shkronja d), nenit 14, nenit 17, shkronja a), si dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), nenin 53, paragrafi 3, të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 20/2016, qershor 2016), nenin 6, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1, nenet 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, si dhe nenit 3, paragrafi 3.7, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronjat a) dhe b), nenit 38, dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Kamenicës Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, Kuvendi i Komunës së Kamenicës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 31.07.2026, miraton këtë:

VENDIM

Për miratimin e vendimit për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale nr. P-71107074-00261-1, e cila sipas Planit Zhvillimor Komunal evidentohet si "zonë minerare", në "tokë industriale"

1. Miratohet vendimi për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale nr. P-71107074-00261-1, Zona Kadastrale Topanice, në pronësi të Komunës së Kamenicës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 459,685 m² (katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë metra katrorë), e cila sipas Planit Zhvillimor Komunal evidentohet si "zonë minerare", në "tokë industriale".
2. Qëllimi i ndryshimit të destinimit të parcelës kadastrale nr. P-71107074-00261-1 është krijimi i kushteve për zhvillimin e veprimtarive ekonomike dhe shfrytëzimin më efikas të pronës komunale, në përputhje me orientimet e planifikimit hapësinor të Komunës së Kamenicës, duke pasur parasysh se në këtë zonë kadastrale, përkatësisht në parcelat kadastrale përreth parcelës objekti të këtij vendimi, është planifikuar destinimi "Park i përgjithshëm, i destinuar për veprimtari ekonomike".
3. Vendimi për ndryshimin e destinimit bazohet në orientimet e planifikimit hapësinor të Komunës së Kamenicës, si dhe në përgjigjen zyrtare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM), të datës 24.07.2026, lidhur me statusin e parcelës objekti të këtij vendimi.
4. Obligohen Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor që propozimin për ndryshimin e destinimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi ta përfshijë në draft-dokumentin e Hartës Zonale të Komunës (HZK), si dhe ta arsyetojë në pjesën tekstuale të këtij dokumenti, i cili është në proces të hartimit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor, Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, si dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë.
6. Ky vendim hyn në fuqi tridhjetë (30) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe pas publikimit në tabelën e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Arsyetim

Komuna e Kamenicës, si pronare e parcelës kadastrale nr. P-71107074-00261-1, Zona Kadastrale Topanicë, ka iniciuar procedurën për ndryshimin e destinimit të propozuar të parcelës, me qëllim të krijimit të kushteve për zhvillimin e veprimtarive ekonomike, shfrytëzimin më efikas të pronës komunale dhe harmonizimin e destinimit të saj me orientimet e planifikimit hapësinor të Komunës së Kamenicës.

Sipas Certifikatës së Pronësisë, parcela kadastrale nr. P-71107074-00261-1 ka sipërfaqe të përgjithshme prej 459,685 m², në pronësi të Komunës së Kamenicës, prej së cilës 50,930 m² evidentohet si "Tokë Bujqësore – Kullosë e Klasës 4", ndërsa 408,755 m² evidentohet si "Tokë Bujqësore – Kullosë e Klasës 6". Ndërkaq, sipas Planit Zhvillimor Komunal, kjo parcelë evidentohet si "zonë minerare".

Nga analiza e dokumenteve të planifikimit hapësinor rezulton se në të njëjtën zonë kadastrale, përkatësisht në parcelat kadastrale që e rrethojnë parcelën objekt të këtij vendimi, është planifikuar destinimi "Park i përgjithshëm, i destinuar për veprimtari ekonomike", çka paraqet orientimin zhvillimor të kësaj pjese të territorit të Komunës së Kamenicës drejt zhvillimit të veprimtarive ekonomike.

Me qëllim të sqarimit të të dhënave lidhur me veprimtarinë minerare në parcelën objekt të këtij vendimi, Komuna e Kamenicës i është drejtuar Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM). Sipas përgjigjes zyrtare të datës 24.07.2026, KPM ka njoftuar se për parcelën kadastrale nr. P-71107074-00261-1, Zona Kadastrale Topanicë, nuk është paraqitur asnjë aplikim për licencë hulumtimi apo shfrytëzimi, nuk është lëshuar asnjë licencë për hulumtim apo shfrytëzim minerar, si dhe nuk është lëshuar asnjë leje për aktivitete të veçanta në këtë parcelë.

Duke marrë parasysh të dhënat e evidentuara në Certifikatën e Pronësisë, destinimin e evidentuar sipas Planit Zhvillimor Komunal, orientimet zhvillimore të zonës përreth, si dhe përgjigjen zyrtare të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, është vlerësuar se propozimi për ndryshimin e destinimit të parcelës, e cila sipas Planit Zhvillimor Komunal evidentohet si "zonë minerare", në "tokë industriale", është në funksion të krijimit të kushteve për zhvillimin e veprimtarive ekonomike dhe shfrytëzimit më efikas të pronës komunale.

Në këtë drejtim, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor do ta përfshijë dhe integrojë propozimin për ndryshimin e destinimit të parcelës kadastrale nr. P-71107074-00261-1 në draft-dokumentin e Hartës Zonale të Komunës (HZK), si dhe do ta arsyetojë atë në pjesën tekstuale të këtij dokumenti, i cili është në proces të hartimit.

Për këto arsye, është propozuar miratimi i këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Nënkrjetures, Shërbimit Profesional të Kuvendit, Drejtorive Komunale, Zyrës për përkthime, Zyrës së Informimit, MAPL-së dhe QSHQ - Arkivit.

Kryesuese e Kuvendit Komunal

Arbnore BEQIRAJFERA